



RIINVEST

INSTITUTI PËR HULUMTIME ZHVILLIMORE
INSTITUTE FOR DEVELOPMENT RESEARCH

Adresa: Rexhep Mala, nr. 27, Aktash 1, Prishtinë, Kosovë

Tel: +381 38 249 320; Fax: +381 249 321; [Http://www.riinvestinstitute.org](http://www.riinvestinstitute.org)

PROMOVIMI I ZHVILLIMIT EKONOMIK NËPËRMES SHOQËRISË CIVILE

ZHVILLIMI RURAL NË KOSOVË (Raport hulumtues)

Ky raport është pjesë e projektit “Promovimi i zhvillimit ekonomik nëpërmes shoqërisë civile” - faza II, dhe realizohet nga Instituti RIINVEST, në mbështetje të Agjencionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) - Misioni në Kosovë.

Qershor 2004

PËRMBAJTJA

Shkurtesat.....	2
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
REKOMANDIMET	5
1. HYRJJE	7
2. ZHVILLIMI KOMPLEKS RURAL DHE RËNDËSIA E TIJ	9
3. ASPEKTET DEMOGRAFIKE NË ZONAT RURALE	11
3.1. Popullsia urbane-rurale dhe struktura moshore	11
3.2. Niveli arsimor i popullsisë rurale.....	12
4. POZITA SOCIO-EKONOMIKE DHE PUNËSIMI NË BUJQËSI.....	14
4.1. Papunësia në zonat rurale.....	14
4.2. Të ardhurat dhe shpenzimet e familjes rurale	14
5. BUJQËSIA, GJENDJA DHE PROBLEMET	17
5.1. Vendi dhe roli i bujqësisë në ekonominë e Kosovës	17
5.2. Sipërfaqet punuese dhe struktura e prodhimit në bujqësi	20
5.3. Fondi blegtoral	22
5.4. Rendimentet e kulturave bujqësore.....	23
5.5 Tregu i produkteve bujqësore	24
6. PARAKUSHTET DHE POLITIKAT E ZHVILLIMIT MODERN RURAL	27
6.1 Rritja e efijencës ekonomike dhe përmirësimi i strukturës së prodhimit bujqësor	27
6.2 Politika fiskale, tregtare dhe subvencionet në bujqësi	28
6.3 Infrastruktura rurale	29
6.4 Financimi dhe kreditimi në zonat rurale	32
6.5 Asistenca teknike në bujqësi	34
6.6 Mekanizimi në bujqësi dhe masat agroteknike	36
6.7 Ndërmarrësia rurale	37
6.8 Organizimi i fermerëve nëpër shoqata	39
6.9 Tregu i tokës dhe privatizimi	40
6.10 Organizimi institucional dhe legjislacioni në bujqësi	42
REFERENCAT	44

Shkurtesat

ABU	(Agro-business Unit) Njësia e Agrobiznesit
AKM	Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit
BE	Bashkësia Evropiane
BPK	Autoriteti i Bankave dhe Pagesave të Kosovës
BSP	(Business Support Centre) Qendra për Mbështetjen e Biznesit
CORDAID	Organizata Katolike për Ndihmë dhe Zhvillim
EJL	Evropa Juglindore
EQL	Evropa Qendrore dhe Lindore
ESK	Enti i Statistikës i Kosovës
GDP	(Gross Domestic Product) Bruto Produkti Vendor
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
IPVK	Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MTT	Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Evropian
OJQ	Organizata Joqeveritare
PCB	Pro Credit Bank (ish-Micro Enterprise Bank)
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UNFPA	Fondi i Popullsisë së Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Profili rural i Kosovës është i kushtëzuar nga madhësia gjeografike, madhësia e tregut, struktura demografike dhe niveli i ulët i zhvillimit ekonomik.

Pjesëmarrja e popullsisë rurale në popullsinë e gjithmbarshme është rreth 60 %. Familja rurale mesatarisht ka 8.3 anëtarë (urbane 6.3 anëtarë). Më shumë se gjysma e fuqisë së aftë për punë është e papunësuar. Papunësia në zonat rurale është 54.5 % (44 % në zonat urbane). Burimet kryesore të të ardhurave të familjeve rurale: paga (58.0 %), remitancat (14.1 %), të ardhurat nga bujqësia (9.1 %), pensionet, asistenca sociale (7.4 %), të tjerat (11.4 %).

Fermat janë të vogla dhe mjaft të shpërndara. Madhësia mesatare e fermës është 2.36 ha, e tokës bujqësore 2.01 ha, e tokës që punohet 1.30 ha dhe 0.7 ha livadhe dhe kulloso. Numri mesatar i parcelave është 3.4. Nga popullsia rurale pa edukim janë 14.0 %, me edukim fillor 41.2 %, të mesëm 37.5 %, dhe të lartë 7.3 %.

Pjesëmarrja e bujqësisë në GDP e përgjithshme vlerësohet rreth 25 %;

Rreth 73 % të familjeve rurale shpenzojnë deri 300 € në muaj (familjet urbane 52 %).

Kosova ka 577.000 ha tokë bujqësore, prej të cilave 272,040 ha janë të mbjellura me kultura të ndryshme bujqësore, ndërsa pjesa tjetër është livadhe, kulloso dhe djerrina. Rreth 88.6 % e tokës bujqësore është në pronën private dhe pjesa tjetër në pronë shoqërore. Fondi i tokës bujqësore dita-ditës po zvogëlohet për shkak të shfrytëzimit për nevoja të tjera. Përveç kësaj, rreth 13 % e tokës bujqësore në sektorin e përgjithshëm privat nuk punohet. Fondi blegtoral është varfëruar shumë pas luftës (rreth 50 %). Aktualisht vetëm rreth 68 % të familjeve rurale mbajnë lopë qumështore, ndërsa mesatarja e përgjithshme për familjet rurale është 1.2 krerë. Në përgjithësi edhe ato familje që mbajnë bagëti dhe punojnë tokën bujqësore nuk arrijnë t'i plotësojnë nevojat e tyre të përgjithshme me produktet përkatëse. Mesatarja e plotësimi të nevojave me produktet që i prodhojnë është rreth 65-68 %. Nëse kemi parasysh se vetëm 55 % të familjeve rurale prodhojnë produkte bujqësore dhe blegtorale, atëherë del se plotësimi i përgjithshëm i nevojave të familjeve rurale me produkte vetanake sillet rreth 33 %. Vetëm një sasi e vogël e prodhimeve bujqësore që prodhohen në sektorin privat është e dedikuar për treg (nga 3.4 % te pemët deri në 27 % te perimet). Kjo tregon për mundësitë e vogla të bujqësisë kosovare për të qenë faktor kyç i zhvillimit ekonomik përgjithësisht dhe i atij rural, në këtë moment. Shkaqet e një gjendjeje të tillë janë të shumta dhe sillen prej rendimenteve të ulëta dhe politikave ekonomike joadekuate që ndikojnë në aftësinë e pamjaftueshme konkurruese, deri te organizimi jo i mirë institucional dhe i fermerëve.

Sistemi i varfër i ujitjes e vështirëson ngritjen e nivelit të prodhimit bujqësor përmes rritjes së produktivitetit dhe rendimenteve për hektarë. Rreth 34 % të familjeve rurale kanë mundësi që në masë të caktuar ta ujin tokën e tyre, që rezulton me 16 % të tokës së përgjithshme të ujitur në sektorin privat. Sistemet e ujitjes janë më të përhapura në rajonin e Dukagjinit. Rendimentet e kulturave bujqësore, sidomos të drithërave, janë të ulëta. Kosova ka 2-3 herë rendimente më të ulëta të drithërave në krahasim me Evropën Perëndimore.

Përkundër një gjendjeje të tillë, gjendja po ndryshon shumë ngadalë. Hap i rëndësishëm është bërë nga ana e Ministrisë me aprovimin e „Strategjisë për zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor dhe rural në Kosovë“ (Libri i gjelbër). Megjithatë, ende nuk është arritur një konsensus shoqëror mbi politikat që duhet zbatuar për të ndryshuar këtë

gjendje, përkatësisht për prioritetet e këtyre politikave. Përmirësimet e fundit në politikën e tarifave doganore për pajisje dhe material riprodhues janë mirëpritur, por janë konsideruar të pamjaftueshme, nëse nuk shoqërohen edhe me masa të tjera komplementare. Kjo përfshin rritjen e efikasitetit ekonomike dhe përmirësimin e strukturës së prodhimit bujqësor, me prioritet për kulturat ku, duke marrë parasysh kushtet specifike kosovare, mund të arrihet aftësi më e lartë konkurruese në tregun e vendit dhe atë të jashtëm.

Kreditimi i bujqësisë dhe zonave rurale është në nivel mjaft të ulët. Edhe pse bankat komerciale e kanë rritur kreditimin e përgjithshëm, pjesëmarrja e bujqësisë në kreditë e lejuara është vetëm rreth 2 %. Përveç bankave, institucionet financiare dhe mikrofinanciare ofrojnë kredi për bujqësi dhe zonat rurale, por intereset janë shumë të larta dhe përballohen me vështirësi. Kreditimi i familjeve rurale është më i vogël në krahasim me ato urbane. Gjithsej 5.7 % të familjeve rurale kanë marrë kredi (10.3 % urbane).

Asistenca teknike në bujqësi ka qenë e ofruar nga organizatat joqeveritare. Ndihmë në farëra të kulturave të ndryshme bujqësore kanë marrë rreth 17 % e familjeve rurale, në plehëra kimike afër 13 % dhe lopë qumështore afër 4 %. Shërbimet këshillimore nga ana e pushtetit qendror dhe lokal nuk janë zhvilluar ende në nivelin e kërkuar. Vetëm rreth 2 % e familjeve rurale kanë marrë ndonjë këshillë profesionale për çështje bujqësore. Mungon shfrytëzimi adekuat i mekanizimit për të zhvilluar aktivitete bujqësore.

Organizimi i fermerëve nëpër shoqata dhe kooperativa është shumë i ulët. Vetëm rreth 2 % të fermerëve janë anëtarë të ndonjë shoqate apo kooperative. Organizimi i fermerëve nëpër shoqata dhe kooperativa do të kishte shumë efekte pozitive, si shfrytëzimi i përbashkët dhe racional i mekanizmit bujqësor, qasja e përbashkët në kreditim, shfrytëzimi i asistencës teknike, këshillave profesionale, trajnimeve etj.

Transaksionet e pronës dhe shitblerja e tokës zhvillohen me mjaft vështirësi. Ekzistojnë shumë procedura burokratike për transferin e pronësisë me rastin e shitblerjeve të tokës, ku taksat për transfer janë mjaft të larta, dhe kjo dallon prej komunës në komunë. Rreth 18.1 % e familjeve rurale deklarojnë se kanë pronë të paregjistruar. Kjo shkakton vështirësi në transaksionet e pronës dhe në qasjen në kredi. Shitblerja e tokës ka qenë prezente më shumë në vitet '80 dhe '90, ndërsa pas luftës kemi një rënie të saj. Toka në pronën shoqërore, në të shumtën, mbetet e pakultivuar dhe, nga ana tjetër, i është ekspozuar keqpërdorimeve. Mbrojtja dhe privatizimi i saj mbetet një çështje aktuale.

Infrastruktura rurale, si rrugët, sistemi i ujësjellësit, i ujitjes, kanalizimi dhe energjia elektrike nuk janë të zhvilluara në nivelin e kënaqshëm. Veçanërisht rrugët e cilësisë së dobët dhe transporti i shtrenjët dhe jo i rregullt, nga viset rurale në ato urbane, determinon me të madhe cilësinë e jetës dhe aktivitetet ekonomike në viset rurale. Kjo kërkon që strategjia e zhvillimit rural të bazohet edhe në mundësitë alternative.

Nga të dhënat e prezentuara del qartë se vetëm bujqësia nuk mund të krijojë të ardhura të mjaftueshme për rritjen e standardit në familjet rurale.

Zhvillimi i bizneseve jobujqësore ka filluar të jetë prezent në Kosovë. Disa aktivitete që lidhen me përpunimin e drurit dhe produkteve bujqësore kanë bërë hapat e parë. Me këtë lidhet edhe shfrytëzimi i produkteve pyjore dhe bimëve mjekuese. Të gjitha këto mund të

paraqesin një bazë të mirë për një program aktiviteteve për të zhvilluar ndërmarrësinë rurale, të bazuar në zhvillimin e biznesit familjar në Kosovë.

REKOMANDIMET

1. Nëpërmjet asistencës financiare dhe teknike, MBPZHR dhe akterët e tjerë – shoqatat e agrobiznesit dhe fermerët, duhet të mbështesin rritjen e produktivitetit për sektorët prioritarë, veçmas të blegtorisë, pemëve dhe perimeve.
2. Në kuadër të ndryshimit të politikave ekonomike, të vazhdohet me lehtësitë fiskale për prodhimtarinë bujqësore. Rekomandohet që të analizohet dhe të përmirësohet zbatimi i TVSH-së dhe harmonizimi i tij me masat tjera të politikave ekonomike dhe vendeve fqinje.
3. Në kuadër të përpjekjeve qeveritare për nxitjen e zhvillimit të sektorëve prioritarë të bujqësisë, të shqyrtohen mundësitë, resurset dhe kapacitetet institucionale për formimin e një fondi për subvencionimin e kamatave për kreditimin e shtimit të prodhimit primar me ndikim në rritjen e participimit në tregun e brendshëm dhe në rritjen e eksportit.
4. Duke pasur parasysh edhe interesat e konsumatorëve, të shqyrtohet mundësia e zbatimit të një mbrojtjeje të lehtë sezonale në sektorët e prodhimit të perimeve brenda suazave të lejuara nga Organizata Botërore e Tregtisë. Këto masa do të zbatoheshin alternativisht duke u përqendruar në:
 - kufizimin sasior (kuotat) për produkte të veçanta bujqësore,
 - ngritjen e përkohshme të tarifave doganore (prelevmanet) dhe
 - kombinimi e dy grupeve të masave të më larta.
5. Në kuadër të përmirësimit të nivelit të organizimit të fermerëve, duhet shtuar përpjekjet për formimin dhe për zgjerimin e shoqatave të reja të fermerëve në sektorë të veçantë të prodhimit bujqësor, si formë efektive e mobilizimit të resurseve, rritjes së sipërfaqeve bujqësore, rritjes së rendimenteve dhe mundësive më të mëdha për përvetësimin e asistencës financiare dhe teknike. Në bashkëpunim me donatorët, MBPZHR dhe komunat të realizojnë projekte për ngritjen e kapaciteteve të këtyre shoqatave.
6. Komunat, agjencionet lokale për zhvillimin e NVM dhe ministritë e involvuara në çështjet zhvillimore të hartojnë një Program për zhvillimin e ndërmarrësisë rurale, duke mobilizuar resurset lokale rurale dhe duke nxitur bizneset familjare (përpunimi i drurit, bimët mjekuese, frutat pyjore, bletaria, turizmi fshatar dhe aktivitete të ngjashme komplementare).

7. Rekomandohet që qeveritë komunale, në bashkëpunim me MTT dhe MBPZHR, në kuadër të strategjive të veta të zhvillimit, të fokusojnë përpjekjet në përmirësimin e infrastrukturës rurale, veçmas në zhvillimin e rrugëve dhe në sigurimin e transportit më të lirë.
8. Në kuadër të diskutimeve të privatizimit, në veçanti të trajtohet çështja e privatizimit të tokës në pronësi shoqërore. Ndërkohë, të sigurohet një mbështetje për formimin e Fondit Publik për mbrojtjen dhe menaxhimin e tokës nëpërmjet dhënies me qira të saj. Është e nevojshme të shqyrtohet mundësia e mbrojtjes ligjore të tokës bujqësore nga uzurpimet dhe ndërtimet e egra.
9. Të vazhdojnë përpjekjet për aftësimin dhe konsolidimin e sistemeve ekzistuese të ujitjes, me qëllim të rritjes së sipërfaqeve të ujitura.

1. HYRJE

Ky raport përmban rezultatet e aktiviteteve kërkimore të Institutit “Riinvest”, në kuadër të projektit “Promovimi i zhvillimit ekonomik nëpërmes shoqërisë civile” lidhur me modulën “Zhvillimi rural në Kosovë”. Ky projekt mbështetet nga Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) – Misioni në Kosovë. Ky raport do të prezantohet në seancën e 12-të të Tryezës së Forumit Ndërkombëtar, e cila pritet të mbahet në fillim të muajit korrik 2004.

Objektivat e këtij raporti janë:

- Përgatitja e një baze analitike për të ngritur një debat cilësor lidhur me çështjet e zhvillimit rural;
- Identifikimi i rolit të bujqësisë dhe aktiviteteve të tjera jobujqësore për zhvillim rural;
- Identifikimi i faktorëve dhe politikave të zhvillimit të qëndrueshëm rural me bazë të gjerë të zhvillimit;
- Rekomandimi i politikave të bujqësisë me fokusim në krijimin e bazës së gjerë për rritje ekonomike në viset rurale.

Zhvillimi rural në Kosovë përballlet me shumë probleme specifike. Standardi më i ulët, papunësia më e madhe e popullsisë rurale, niveli i ulët i prodhimit bujqësor dhe në përgjithësi mungesa e një politike të qëndrueshme për zhvillimin rural e kanë motivuar “Riinvestin” për hartimin e këtij raporti.

Përgatitjes së këtij raporti hulumtues i kanë paraprirë një sërë aktivitete:

- Takime me akterë kyç në aktivitetet e bujqësisë dhe zhvillimit rural (*Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Komisioni Parlamentar për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Aleanca Kosovare e Agrobiznesit, Shoqata “Anadrini”, etj*);
- Analizimi i studimeve dhe publikimeve në dispozicion për bujqësinë dhe zhvillimin e zonave rurale;
- Analizimi i studimeve (raporteve hulumtuese) të “Riinvestit”;
- Anketa me 1000 familje në Kosovë (542 rurale dhe 458 urbane);
- Asistenca teknike e realizuar nga konsultanti Richard Beilock, profesor i Univeristetit të Floridas (SHBA);
- Krijimi i një grupi pune me ekspertë vendës për diskutimin e çështjeve kyçe;

Realizimi i anketës me 1000 familje (900 shqiptare dhe minoritete të tjera joserbe dhe 100 familje serbe, nga të cilat 542 familje kanë qenë nga zonat rurale dhe 458 nga ato urbane) ka qenë shumë i rëndësishëm për të kompletuar mungesën e të dhënave, sidomos për aspektet socio-ekonomike. Objekt i hulumtimit kanë qenë familjet, prej të cilave janë mbledhur të dhëna për pronën e tyre të paluajtshme, aktivitetet bujqësore dhe blegtorale, kushtet dhe standardin jetësor të tyre, që në përgjithësi mundësojnë krijimin e një pasqyre të qartë për zhvillimin rural. Përcaktimi që anketa të bëhet edhe me familje urbane ka qenë i motivuar me nevojën për krahasimin e pozitës së familjeve rurale me ato urbane, me qëllim që të shihet edhe më mirë gjendja e familjeve rurale, por edhe nga fakti se një

numër i konsiderueshëm i familjeve urbane janë mjaft të lidhura me fshatin. Mostra e rastësishme është formuar në bazë të regjistrit të familjeve në administratën e tatimit në pronë.

Ky raport përmban aspekte të ndryshme të zhvillimit rural, duke filluar me rëndësinë e zhvillimit kompleks të tij, vazhdon me aspektet demografike rurale dhe pozitën socio-ekonomike, duke u fokusuar në çështjet e punësimit dhe në standardin jetësor. Pastaj, elaborohet rëndësia e bujqësisë në zhvillimin ekonomik të Kosovës, ecuritë e zhvillimit të kësaj dege, me theks të veçantë në sektorin privat. Në fund, janë dhënë parakushtet dhe politikat për një zhvillim modern rural, duke filluar nga formimi i politikave të nevojshme për mbështetjen e zhvillimit rural, ristrukturimin e bujqësisë dhe sistemet e financimit, infrastrukturës dhe sistemeve të tjera të mbështetjes së bujqësisë.

Instituti “Riinvest” dëshiron t’i falënderojë të gjithë ata që ndihmuan në zhvillimin e aktiviteteve kërkimore në përgatitjen e këtij raporti: Institucionet kosovare; USAID-in - Misioni në Kosovë, për mbështetje dhe konsultime substanciale. Posaçërisht falënderojmë shumë, pas punës jashtëzakonisht korrekte, z.Richard Beilock – konsultant nga Universiteti i Floridas (SHBA) për kontributin e dhënë në përcaktimin e metodologjisë së hulumtimit dhe kontributin shumë të vlefshëm në analizën e të dhënave të anketës dhe raportet e prezentuara. Falënderojmë familjet e anketuara për gatishmërinë që t’i përgjigjen anketës, si dhe intervistuesit. Falënderojmë edhe ekspertët vendës (Skënder Kaçiu, Asllan Pushka, Menderes Ibraj, Tomë Hajdaraj dhe Mentor Thaçi) për debatet dhe kontributin e tyre.

Gjatë përgatitjes së këtij raporti, stafi i “Riinvestit” ka mbajtur një sërë takimesh dhe konsultimesh me akterët e lartpërmendur. Sidoqoftë, rezultatet, interpretimet dhe konsultimet janë në përgjegjësi të “Riinvestit” dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht qëndrimet e të tjerëve.

2. ZHVILLIMI KOMPLEKS RURAL DHE RËNDËSIA E TIJ

Zhvillimi rural është proces në të cilin njerëzit në viset rurale (individët, amvisëritë, komuniteti, fermerët etj.) i bashkojnë resurset e tyre për të përmirësuar kushtet jetësore dhe të punës. Përmes përmirësimit dhe rritjes së shkathhtësive të tyre, ata synojnë të rrisin kapacitetet e përgjithshme individuale dhe të organizatave të tyre komunitare, për të përmirësuar të ardhurat e tyre, shëndetin, edukimin, infrastrukturën dhe shërbimet tjera sociale. Së fundi, banorëve të zonave rurale u jipet mundësia që të kontribuojnë për lirinë civile, të menaxhojnë vet zhvillimin e tyre, me marrëdhënie të balancuara gjinore dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të ambienteve rurale.

Qasja bashkëkohore lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm rural nënkupton një qasje komplekse, e cila përfshin: bujqësinë, resurset nacionale dhe menaxhimin e tyre, transportin rural, ujin dhe higjienën, telekomunikimet, edukimin, shëndetësinë, shërbimet sociale.

Lidhur me këtë Banka Botërore ka lansuar strategjinë e rinovuar të zhvillimit rural (a Renewed Strategy for Rural Development – Reaching Rural Poor: Për një strategji të përtërirë të zhvillimit rural – të pasurohen të varfërit ruralë), e cila fokusohet:

- (a) në të varfërit ruralë që përbëhen nga ata që nuk kanë tokë, kanë asete të pakta, gratë udhëheqëse të familjeve);
- (b) në rritjen ekonomike me një bazë të gjerë (bujqësia është burimi themelor i rritjes ekonomike, por këtu inkluadohen edhe aktivitetet e ashtuquajtura "non farm activities" - biznese jashtë bujqësisë);
- (c) në qasje komplekse (ekzistojnë shumë pjesë të mozaikut - varfëria, aspektet gjinore, cilësia e qeverisjes, menaxhimi i resurseve, barazia sociale);
- (d) aleanca me akterët e interesuar (qeveria, agjencitë zhvillimore, shoqëria civile, sektori privat);
- (e) ndikimet e zhvillimit global – globalizimi;

Objektivat strategjike të një strategjie dhe qasjeje të tillë sipas Bankës Botërore do të ishin:

- (1) Krijimi i mjedisit për një zhvillim me bazë të gjerë dhe të qëndrueshëm rural;
- (2) Rritja e produktivitetit të bujqësisë dhe aftësisë së saj konkurruese;
- (3) Rritja ekonomike e bazuar në aktivitete jashtë bujqësisë dhe "aktivitete jashtë fermave";
- (4) Përmirësimi i mirëqenies sociale;
- (5) Përmirësimi i menaxhimit të resurseve natyrore;

Lidhur me një qasje të tillë duhet theksuar se nuk mund të kontestohet ndikimi i fuqishëm i bujqësisë në sektorët tjerë dhe në zvogëlimin e varfërisë. Në dokumentin e cituar të Bankës Botërore rritja e GDP bujqësore për një banor prej 1 % ndikon në rritjen e GDP së të varfërve për 1.6 %. Rritja e bujqësisë gjeneron kërkesën për rritjen e sektorëve të tjerë (kërkesën për inpute si dhe lëndë të para për përpunim).

Megjithatë, vetëm orientimi në zhvillimin e bujqësisë nuk mund të rezultojë me zhvillim të qëndrueshëm rural. Një konstatim i tillë është aktual

sidomos për Kosovën, duke marrë parasysh nivelin e varfërisë dhe të papunësisë rurale, sipërfaqet e vogla të tokës së punueshme për një familje rurale, faktorët limitues për zhvillimin e një prodhimi konkurrues bujqësor në Kosovë në tregun e brendshëm dhe të jashtëm, afërsinë e fshatrave / viseve rurale me qendrat dhe shtatë qytetet më të mëdha në Kosovë. Për strategjinë e zhvillimit rural në Kosovë dhe ndërtimin e një strategjie të qëndrueshme të zhvillimit të bujqësisë këta faktorë kufizues duhet të valorizohen me kujdes, në mënyrë që resurset e kufizuara natyrore dhe buxhetore të fokusohen në ato prioritetet dhe sektorë të bujqësisë që rezultojnë me efekte më të mëdha për rritjen e mirëqenies, jo vetëm në viset rurale por përgjithësisht.

Dilemat dhe problemet e tilla e bëjnë të domosdoshëm përkufizimin e profilit të zhvillimit rural në bazë të politikave nacionale të definuara mirë dhe të bazuara në strategjitë e zhvilluara nga akterët e interesuar, sidomos nga qeveria, komunat, komunitetet - fshatrat dhe bashkësitë lokale, fermerët dhe asociacionet e tyre.

Në rastin e Kosovës kjo është edhe më aktuale pasi viset rurale kanë qenë zonat më të goditura gjatë luftës, kështu që popullsia e saj është përballur me vështirësi të shumta në fazën e pasluftës. Fondi i blegtorisë është zvogëluar për rreth 50 %, kurse pajisjet dhe mekanizimi i dëmtuar ose i humbur arrin në shkallën 70 %. (Anketa me 3500 familje, Riinvest, gusht 1999). Bujqësia si aktivitet tipik në fshat ka shënuar rënie për shkak të këtyre pasojave dhe pjesërisht për shkak të orientimit të popullsisë për zgjidhjen e çështjeve të banimit. Ekziston vlerësimi se riparimi i këtyre pasojave po shkon shumë ngadalë. Ka qenë prezente një lëvizje më e madhe e popullsisë drejt zonave urbane. Te fermerët dhe popullsia ekziston bindja se ende nuk është formuar një sistem masash dhe politikash për tejkalimin e problemeve të zhvillimit rural. Të gjitha këto paraqesin sfida për arritjen e objektivit për zbutjen e diferencave zhvillimore ndërmjet zonave rurale dhe urbane, si dhe për zvogëlimin e varfërisë rurale nëpërmjet rritjes së mundësive dhe shansave të popullsisë rurale për të pasur qasje dhe për të marrë pjesë në aktivitete që gjenerojnë të ardhura dhe i kontribuojnë zhvillimit të vendit.

3. ASPEKTET DEMOGRAFIKE NË ZONAT RURALE

3.1. Popullsia urbane-rurale dhe struktura moshore

Duke pasur parasysh trendin e rritjes së popullsisë dhe komponentin e emigracionit, vlerësohet se Kosova ka rreth 2.5 milionë banorë, prej të cilëve rreth 450 mijë jetojnë si emigrantë jashtë Kosovës. Nga kjo rezulton se në Kosovë ka rreth 2.05 milionë banorë (Riinvest, Tregu i punës dhe papunësia, 2003).

Në mungesë të shënimeve të sigurta, pjesëmarrja e popullsisë rurale në Kosovë vlerësohet rreth 60 %. Në vitet e 90-ta jo që nuk pati zhvillim ekonomik, por nuk pati as lëvizje migruese brenda dhe mes komunave, andaj nuk pati as ndryshime të dukshme në mes popullsisë rurale e urbane. Ky raport pësoi ndryshime menjëherë pas luftës së vitit 1999, me vendosjen e një pjesë të popullsisë rurale në qytete për të siguruar strehë për familjet që i kishin shtëpitë e djegura e të shkatërruara, pastaj për të ardhur më lehtë deri të ndihmat nga organizatat e ndryshme humanitare dhe për të gjetur punë në qytete.

Krahasuar me pjesëmarrjen e lartë të popullsisë rurale në Kosovë, kjo përqindje në disa vende është: Rusi 22, Bullgari 30, Hungari 36, Kroaci 42, Slloveni 43, Rumani 44, Bosnje dhe Hercegovinë 55.

Përkundër mungesës së të dhënave, tabela e mëposhtme tregon për një zvogëlim të vazhdueshëm të popullsisë rurale në dobi të asaj urbane.

Tabela 1: Numri i popullsisë në Kosovë dhe shpërndarja fshat-qytet (1981-2002)

	1981	1991	2002
Popullsia, në '000	1.584	1.944	2.500
Rurale (%)	67.5	65	~60
Urbane (%)	32.5	35	~40

Burimi: 1981: Burimi: Studimet e Entit për Zhvillim dhe Planifikim të Kosovës (1988).

2002: Riinvest (2002): Anketa me familje dhe me tregun e punës në Kosovë

Në një Evropë që gjithnjë po plaket, popullsia e Kosovës bën një përjashtim. Afërsisht një e treta e popullsisë është nën moshën 15 vjeçare. Krahasuar me 20 vjet më parë, pjesëmarrja e popullsisë së re është zvogëluar për gati 10 % (te grupmosha 0–14 vjet nga 41.4 % në 31.6 %). Në vitin 2000 popullsia e re (0–19 vjet) përbënte 42.6 % të popullsisë së tërësishme (shih kolonën e fundit në tabelën më poshtë). Ndërsa, në vitin 1981 kjo grupmoshë përbënte 52.3 % të popullsisë. Ky zvogëlim i popullsisë së re është rezultat i zvogëlimit të shtimit natyror nga rreth 45 mijë banorë për vit sa ishte në fund të viteve të 80-ta (1986/90) në rreth 36 mijë në vitet e 90-ta dhe rreth 30 mijë në vitet e pasluftës.

Nëse analizohet popullata në moshë pune (popullata 16-64 vjeç) mund të shihet se rreth 60 % e popullsisë janë të kësaj moshe. Brengosës është fakti se norma e joaktivitetit është e lartë, posaçërisht për femrat. Këto çështje janë analizuar më poshtë.


Për shkak të popullsisë së re, Kosova është e njohur si vend me numër shumë të vogël të popullsisë mbi moshën 64 vjeç. Ky është një fakt lehtësues për buxhetin e shtetit. Në vendet tjera kjo normë sillet rreth 25 %.

Në tabelën më poshtë është paraqitur struktura moshore e popullsisë sipas zonave urbane dhe rurale. Po ashtu, në grafik mund të shihet qartë se popullsia në zonat rurale është më e re se në zonat urbane. Kjo natyrisht vë në rezultat i shtimit më të madh të popullsisë në zonat rurale.

Table 2: Grupmoshat e popullsisë sipas zonave urbane dhe rurale

Grup-moshat	Popullsia rurale gjithsej	Popullsia urbane	Popullsia gjithsej
0 – 4	11.8	8.3	10.1
5 – 9	12.0	9.6	10.7
10–14	11.3	10.0	10.6
14–19	11.1	10.9	10.9
20–24	9.6	9.5	9.5
25–29	7.6	7.5	7.5
30–34	6.7	6.4	6.6
35–39	5.4	6.7	6.0
40–44	4.7	6.5	5.7
45–49	4.3	6.6	5.6
50–54	3.6	5.4	4.6
55–59	3.2	4.0	3.7
60–64	2.9	3.3	3.1
65+	5.9	5.0	5.3
Total	100.0	100.0	100.0

Fig. 1: Moshë e popullsisë sipas zonave



Burimi: Anketa e vitit 1999/2000 përgatitur nga UNFPA, ESK, IOM, 2000

Nga të dhënat e mësipërme del se popullsia rurale është më e re sesa ajo urbane, veçanërisht deri në 24 vjet, të cilët te popullsia rurale kanë pjesëmarrje rreth 57 %, kurse te ajo urbane 48 %.

Familjet në zonat rurale mesatarisht kanë nga 8.3 anëtarë, derisa ato nga zonat urbane nga 6.3 anëtarë, duke dhënë një mesatare të përgjithshme prej 7.4 anëtarë për familje.

3.2. Niveli arsimor i popullsisë rurale

Për të analizuar nivelin arsimor të popullsisë në Kosovë në përgjithësi dhe në zonat rurale janë përdorur të dhënat nga “Anketa e “Riinvestit” me familje dhe me tregun e punës”, e zhvilluar në dhjetor të vitit 2002. Nga këto të dhëna është nxjerrë niveli arsimor i popullsisë për personat e moshës 24 vjeç e sipër, me qëllim që të koncentrohemi vetëm në nivelin arsimor të kompletuar e jo edhe në atë vijues. Megjithatë mund të ketë persona që vazhdojnë arsimimin edhe pas kësaj moshe, numri i tyre është josingjifikant për të ndryshuar mesataren e përgjithshme. Këto të dhëna janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Në përgjithësi popullsia nga zonat rurale ka nivel më të ulët të arsimimit krahasuar me popullsinë e zonave urbane. Rreth 41 % e popullsisë rurale janë me arsimim fillor krahasuar me vetëm 28 % të popullsisë nga zonat urbane. Popullsia nga zonat urbane ka kryesisht arsimim të mesëm dhe të lartë, derisa ajo nga zonat rurale ka arsimim kryesisht fillor dhe të mesëm.

Tabela 3: Struktura arsimore e popullsisë sipas zonave urbane/rurale (pop. 24+)

Shkalla e edukimit	Urbane	Rurale	Totali
1. Pa edukim	9 %	14 %	12 %
2. Fillor	28 %	41 %	35 %
3. E mesme	46 %	38 %	41 %
4. E lartë	18 %	7 %	12 %
Totali	100 %	100 %	100 %

Burimi: Anketa me familje, Riinvest, dhjetor 2002

Aktualisht nga numri i përgjithshëm i studentëve të UP, 33 % janë nga zonat rurale që reflekton një strukturë të pavolitshme të të rinjve nga zonat rurale në arsimin e lartë. Bazuar në raportet popullsi urbane/rurale, kjo përqindje do të duhej të ishte dukshëm më e lartë.¹

Sipas të dhënave nga UNFPA, ESK, IOM, pjesëmarrja e popullsisë analfabete² është 6.5 %, dukshëm më e ulët te meshkujt (2.3 %) sesa te femrat (10.2 %). Analfabetizmi është më i lartë për zonat rurale (8.8 %) sesa në ato urbane (4.3 %). Nga 100 persona aktivë në bujqësi, 62 ishin me shkollë fillore e më pak, 30 me shkollë të mesme dhe 8 me shkollë të larta e fakultete. Bujqësia e ka nivelin më të ulët arsimor të fuqisë punëtore, industria diç më të mirë, aktivitetet shërbyese dukshëm më të mirë.

Në bujqësi, fuqia punëtore ose është e moshuar ose e re. Pak ka të moshës së mesme, gjë që ka efekte negative për zhvillimin e kësaj dege. Në industri, energjetikë, xehetari e konstruksione pjesa dërrmuese e fuqisë punëtore ishte e moshës mbi 40 vjeçare, që po ashtu paraqet një pengesë reale për zhvillimin e saj.

¹ Sistemi i arsimit dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës, Riinvest, shkurt 2004.

² Analfabetizimi shprehet si përqindje e popullsisë mbi moshën 10 vjeçare që nuk dinë të shkruajnë dhe të lexojnë.

4. POZITA SOCIO-EKONOMIKE DHE PUNËSIMI NË BUJQËSI

4.1. Papunësia në zonat rurale

Kosova është njëra nga vendet e fundit që fillon rrugën drejt tranzicionit për të ndërtuar një ekonomi tregu. Përbërja e forcave të punës në Kosovë determinohet nga tre faktorë: popullata shumë e re, shkalla e lartë e emigracionit dhe zhvendosja e popullsisë gjatë luftës. Duke përdorur të dhënat nga anketa e „Riinvestit“ me familje dhe me tregun e punës (dhjetor 2002), kemi paraqitur treguesit kryesorë për punësimin dhe papunësinë për zonat rurale dhe urbane. Mund të shihet se të gjithë treguesit për zonat rurale janë më të disfavorshëm krahasuar me zonat urbane. Norma e aktivitetit është më e ulët për zonat rurale (57 % krahasuar me 62 % sa është në zonat urbane). Në anën tjetër, niveli i papunësisë në zonat rurale është për rreth 10 % më i lartë se në zonat urbane.

Tabela 4: Indikatorët e tregut të punës në Kosovë sipas zonave rurale dhe urbane

	Total	Urban	Rural
Norma e aktivitetit	58.0 %	61.6 %	54.7 %
Norma e punësimit	51.0 %	56.4 %	45.5 %
Norma e papunësisë	49.0 %	43.6 %	54.5 %

Burimi: Anketa e „Riinvestit“ me familje dhe me tregun e punës (2002)

4.2. Të ardhurat dhe shpenzimet e familjes rurale

Si rezultat i gjendjes së pafavorshme në sektorin e bujqësisë, të ardhurat nga bujqësia marrin pjesë me një përqindje fare të vogël (mesatarisht 9.1 %) në të ardhurat e përgjithshme të familjes rurale. Shumica e të ardhurave të familjeve rurale (58.0 %), vijnë nga anëtarët e familjes që janë të punësuar me pagë. Një pjesë e konsiderueshme e të ardhurave (14.1 %), vijnë nga pjesëtarë të familjes që jetojnë në vende të tjera. Pra, bujqësia nuk siguron të ardhura të mjaftueshme për sigurimin e ekzistencës së familjeve rurale.

Karakteristikat që e dallojnë strukturën e të ardhurave të familjeve rurale me ato urbane janë të ardhurat nga bujqësia, remitancat nga jashtë dhe asistenca nga të afërmit në Kosovë. Të gjitha këto burime të të ardhurave janë më të larta te familjet rurale. Ndërsa, të ardhurat nga biznesi dhe pagat e të punësuarve janë më të larta për familjet urbane.

Pjesëmarrja më e lartë e remitancave në strukturën e të ardhurave të familjeve rurale në krahasim me urbanet është razultat i migrimit më të madh të popullsisë rurale në vendet e jashtme. Sa i përket asistencës nga të afërmit brenda vendit, familjet rurale kanë pjesëmarrje më të lartë të kësaj kategorie në strukturën e të ardhurave, sepse ndonjë anëtar i familjes rurale migron në qytet për shkak të mundësive më të mëdha të punësimit. Njëherit ky faktor (i mundësive më të mëdha të punësimit në qytet) ndikon që të ardhurat nga punësimi te familjet urbane të jenë në nivel më të lartë sesa te ato rurale. Mundësitë më të mëdha për punësim në qytet janë si rezultat i kushteve dhe mundësive

më të mira të zhvillimit të bizneseve dhe kjo ndikon që kategoria e të ardhurave nga biznesi në familjet urbane të jetë më e lartë.

Tabela 5: Struktura e burimeve të të ardhurave të familjeve rurale (%)

Burimet e të ardhurave të familjeve	Rurale	Urbane
Të ardhurat nga bujqësia	9.1	1.7
Të ardhurat nga biznesi jobujqësor	4.2	17.2
Pagat e të punësuarve	58.0	64.8
Asistenca nga të afërmit /shokët në Kosovë	6.0	2.1
Remitancat	14.1	6.4
Asistenca nga organizatat ndërkombëtare	1.2	0.9
Pensione, asistenca sociale	7.4	6.4
Total	100.0	100.0

Burimi: Anketa me familje, Riinvest, 2004

Në një situatë të tillë, krijimi i të ardhurave nga bujqësia ende është shumë i vogël. Shumica e familjeve rurale të anketuara (67.1 %) deklarojnë se nuk posedojnë të ardhura të cilat mund t'i përdorin për investime. Edhe ata që posedojnë ndonjë shumë të mjeteve financiare, shumica prej tyre nuk mendojnë që këto mjete t'i përdorin për investime në bujqësi.

Duke u bazuar në këto të dhëna vërehet se mundësitë e familjes rurale për investime në bujqësi janë shumë të kufizuara. Është e nevojshme që të gjenden forma të investimeve fillestare (përmes kreditimeve në kushte të favorshme), në mënyrë që fermerët të fillojnë të prodhojnë më tepër për treg.

Fermat e vogla mesatarisht nuk i plotësojnë as nevojat e familjes për shumicën e prodhimeve bujqësore. Plotësimi i nevojave të familjeve rurale me produkte bujqësore nga prodhimi vetanak është rreth 70 %. Në tabelën e mëposhtme janë dhënë vlerat mesatare të plotësimit të nevojave për ata që i prodhojnë këto prodhime bujqësore.

Tabela 6: Plotësimi i nevojave me produkte bujqësore nga prodhimi vetanak i familjeve rurale (%)

Produkte drithi dhe misri	73.5
Perime	61.1
Fruta pemësh	49.7
Prodhime qumështi	90.3
Vezë	72.0
Mish	63.8

Burimi: Anketa me familje, Riinvest, 2004

Për t'u bindur me gjendjen e rëndë materiale të popullsisë rurale, sidomos të atyre ekonomive familjare që varen prej pronave të vogla dhe nuk kanë të punësuar në botën e jashtme ose në vend në veprimtaritë tjera jashtë ekonomisë familjare, do t'i japim të dhënat për strukturën e ekonomive familjare sipas shpenzimeve mujore të familjes rurale dhe asaj urbane.

Tabela 7: Shpenzimet mujore të familjeve rurale dhe urbane (%)

	Rurale	Urbane
Më pak se 100 €	11.6	8.5
100 - 200 €	29.5	17.0
200 - 300 €	31.9	26.6
300 - 500 €	18.3	26.6
500 - 1000 €	5.9	9.4
Mbi 1000 €	1.3	3.9
Nuk mund të tregoj	1.5	7.8

Burimi: Anketa me familje, Riinvest, 2004

Rreth 73 % e familjeve rurale shpenzojnë deri në 300 € në muaj (familjet urbane rreth 52 %)

Shumica e ekonomive familjare (58.1 %) kanë deklaruar se të ardhurat në vitin 2003 ishin të njëjta sikurse në vitin paraprak, gati 1/3 (28.4 %) kishin më pak të ardhura dhe vetëm 12.5 % kishin pasur të ardhura më të larta. Një pjesë e dukshme e ekonomive familjare (41.1 %) konsiderojnë se pengesë kryesore për rritjen e të ardhurave është mungesa e financimit nga bankat ose institucionet tjera, mbi ¼ (26.4 %) e fajësojnë papunësinë, 1/6 e ekonomive familjare (16.7 %) e konsiderojnë tregun e paorganizuar si shkaktar të mosritjes së të ardhurave dhe 13 % mungesën e pajisjeve. Pjesa dërmuese e ekonomive familjare (87.6 %) edhe ato pak prodhime që i shesin në treg, i shesin vet, shumë pak këtë e bëjnë në forma të organizuara.

5. BUJQËSIA, GJENDJA DHE PROBLEMET

5.1. Vendi dhe roli i bujqësisë në ekonominë e Kosovës

Ekonomia bujqësore është një segment i rëndësishëm i aktivitetit ekonomik në Kosovë. Ky sektor arrin të absorbojë një numër të konsiderueshëm të fuqisë punëtore në tërësi, e posaçërisht të fuqisë punëtore në zonat rurale. Sipas vlerësimeve,³ sektori i bujqësisë në Kosovë në vitin 1996 ka kontribuar me rreth 30 % në GDP-në e përgjithshme. Megjithatë, kjo rritje e pjesëmarrjes së bujqësisë në produktin e përgjithshëm gjatë vitetve të 90-ta (shih tabelën më poshtë) ka ardhur si rezultat i ngushtimit dhe rënies së aktivitetit ekonomik në degët tjera të ekonomisë. Rëndësia e sektorit të bujqësisë në vendet e EJT-së mund të shihet edhe nga aspekti i kontributit të këtij sektori në GDP (shih tabelën 9).

Tabela 8: Pjesëmarrja e veprimtarive kryesore në produktin e përgjithshëm

	1971	1975	1980	1988	1994	1995	1996
Industria	33.3	36.5	36.4	47.4	32.3	37.0	33.8
Bujqësia	28.2	23.8	18.6	20.4	35.4	34.2	28.8
Veprimtaritë tjera	38.5	39.7	45.0	32.2	32.3	28.8	37.4
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: Vjetari statistikor i Kosovës dhe RFJ, vitet e ndryshme, Riinvest (1998)

Në përgjithësi mungojnë të dhënat statistikore mbi numrin e të punësuarve në bujqësi. Është me interes të studiohet dukuria e hasur në fillim të procesit të tranzicionit, kur disa vende shkuan drejt agrikulturizimit të mëtejshëm, siç është rasti me Poloninë dhe Bullgarinë. Vlerësohet se në fillim të vitit 1997 në Kosovë, duke mos llogaritur komponentën e migrimit, kishte rreth 325 mijë familje nga të cilat në fshat ishin rreth 185 mijë. Nga numri i përgjithshëm, 82 mijë janë familje bujqësore, rreth 85 mijë të përziera dhe 18 mijë jobujqësore (Riinvest, 1998). Duke u nisur nga këto fakte, konsiderohet se numri i të punësuarve në bujqësi në vitin 1996 ishte rreth 106.000 veta.

Pas luftës ka pasur disa vlerësime për numrin e të punësuarve në bujqësi. Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, bujqësia përbën rreth 20 % të punësimit të përgjithshëm. Kjo përqindje është shumë e lartë, posaçërisht për gjininë mashkullore (nga numri i përgjithshëm i meshkujve të punësuar vlerësohet se 41 % janë të punësuar në bujqësi).

Tabela 9: Pjesëmarrja e bujqësisë në GDP në disa vende të rajonit

Vendi	Pjesëmarrja e bujqësisë në GDP (%)
B&H	17.5
Bullgari	8.0
Kroaci	9.2
Maqedoni	12.0
Rumani	19.6
EJT (mesatarja)	16.2
EJT-5 ^a (mesatarja)	4.7

^a Rep.Çeke, Hungaria, Polonia, Sllovakia dhe Sllovenia.

Burimi: Banka Botërore; EBRD Transition Report, 1999.

³ Burimi: Vjetari statistikor i Kosovës dhe RFJ, vitet e ndryshme, Riinvest (1998)


Sipas vlerësimeve të “Riinvestit” (2003), bujqësia punëson diku rreth 100.000 persona apo rreth 22 % të punësimit të përgjithshëm. Këto vlerësime të “Riinvestit” janë dhënë në bazë të anketës me 1.252 familje në dhjetor të vitit 2002.

Enti i Statistikës i Kosovës në një publikim në vitin 2001 vlerësonte se punësimi në bujqësi (në bazë të numrit të atyre që marrin pagë të rregullt) përbën rreth 14 % të punësimit total. Këtu nuk përfshihen ata që punojnë në bujqësi kohë pas kohe, si dhe ata që punojnë në bujqësi por nuk marrin pagë.

Dëmet nga lufta në sektorin e bujqësisë ishin mjaft të mëdha, si në objekte përcjellëse, mekanizim, blegtori etj. Përveç tyre, kjo situatë ndikoi edhe në humbjen e tregut, në dëmtimin e madh të infrastrukturës rurale, në shkatërrimin gati në tërësi të industrisë përpunuese ushqimore, si dhe në rënien e theksuar të rendimenteve të kulturave bujqësore. Kësaj shtate në masë të konsiderueshme i ka kontribuar edhe mungesa e investimeve në bujqësi për një kohë të gjatë, dukuri që po vazhdon ende. Si pasojë e kësaj shtate, Kosova është kthyer në një importues të prodhimeve bujqësore. Në vitin 2003, produktet bujqësore të importuara përbënin rreth 25 % (rreth 250 milionë euro) të vlerës së përgjithshme të importit në Kosovë. Eksporti i prodhimeve bujqësore ishte fare i vogël (rreth 7 milionë euro apo 18 % e eksportit të përgjithshëm). Këto eksporte përfshijnë kërputha të thara, patate, lëkura të kafshëve dhe lëngje.⁴

Pjesëmarrja e bujqësisë në GDP është rreth 25 %. Krahasuar me vendet tjera, kjo pjesëmarrje është mjaft e lartë.

Fig 2: Struktura e GDP-së: Maqedonia, Sllovenia dhe Kosova



Burimi: CIA for Macedonia and Slovenia. Estimate based upon USAID, 2003b and UNMIK
(The sirens' song of agriculture: Opportunities and traps for Kosov by Richard Beilock)

Pas luftës, donatorë të ndryshëm kanë ndihmuar në rimëkëmbjen e bujqësisë në Kosovë. Në fazën e parë ndihmat kanë qenë kryesisht emergjente dhe janë bazuar në grante (lopë qumështore, mekanizim, serra etj.). Tani ka filluar faza e dytë - faza zhvillimore, që ka të bëjë me krijimin e politikave më të favorshme në bujqësi, me transferimin e njohurive për

⁴ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

teknologjitë e reja të kultivimit të fermerët dhe me orientimin e prodhuesve bujqësorë drejt prodhimit komercial.

Edhe pse është sektori kryesor në ekonominë e Kosovës, bujqësisë ende nuk i është dhënë mbështetja me projekte zhvillimi afatmesme dhe afatgjata. Kjo është mëse e nevojshme pasi mbështetja emergjente nga donatorët e ndryshëm ka përfunduar dhe projektet momentale të donatorëve janë kryesisht mbështetje teknike dhe këshillimore, që janë shumë të nevojshme por njëherit duhen edhe investime në sektor.

MBPZHR ka buxhet shumë të vogël, paga të pamjaftueshme për stafin vendës dhe burime të pamjaftueshme që të mbulojë kërkesat e një sektori kaq të madh. Po ashtu është me rëndësi të rritet bashkëpunimi mes MBPZHR dhe ministrive të tjera, sidomos MEF dhe MTI, në mënyrë që të rritet përfitimi i sektorit.

Shumica e fermave në Kosovë janë shumë të vogla dhe në masën më të madhe ato janë të orientuara në prodhimin për nevojat e familjes. Vetëm një sasi e vogël e prodhimit në fermë i dedikohet tregut. Edhe pse ka një orientim të theksuar drejt prodhimit komercial, megjithatë bujqësia e Kosovës ende dominohet nga fermerë të vegjël.

Sipërfaqet me drithëra përfshijnë sipërfaqet më të mëdha. Bimët industriale (duhani, panxhar sheqeri, luledielli), si pasojë e mosfunksionimit të industrisë përpunuese, pothuajse nuk mbillen fare (ose në sipërfaqe shumë simbolike). Në sipërfaqe diç më të mëdha mbillet elbi i birrës, i cili prodhohet për nevojat e Fabrikës së Birrës në Pejë.

Sipërfaqet me perime dhe patate kanë tendencë të rritjes, duke arritur sipërfaqet që kanë qenë para luftës. Gjendje më e vështirë është në sektorin e pemëtarisë dhe vreshtarisë, ku si pasojë e mosmirëmbajtjes së sipërfaqeve ekzistuese (shumë prej tyre ndodhen në sektorin shoqëror) dhe mosmbjelljes së sipërfaqeve të reja, ky sektor është sjellur në situatë mjaft të vështirë.

Nga të dhënat në tabelën në vijim vërehet se për shumicën e prodhimeve bujqësore nuk prodhohet aq sa janë nevojat e Kosovës. Niveli i plotësimit të nevojave është më i ulëti tek pemët (29 %), pastaj vijnë perimet (52 %), gruri (57 %) dhe luledielli (14 %). Tepricë ka vetëm tek patatja dhe rrushi. Derisa patatja në vitin e kaluar është eksportuar, teprica e rrushit është më tepër pasojë e mospërpunimit të tij dhe e vështirësive në lidhje me shitjen e verës.

Tabela 10: Llogaritja e kërkesave dhe furnizimeve për kulturat bimore

	Sip. (ha)	Prodhimi		Kërkesa (ton)	Deficiti	Teprica	Përqindja e kërkesave të plotësu.
		ton/ha	ton				
Gruri	72.000	3.0	216 000	380 000	164 000		57 %
Misri	72 019	3.6	259 268	324 317	65 049		80 %
Tërshëra	12 778	1.4	17 889	140 164	122 275		13 %
Elbi	3 500	2.8	9 800	15 000	5 200		65 %
Patatja	6 952	13.4	93 157	48 000		45 157	194 %
Luledielli	2 000	1.2	2 400	16 632	14 232		14 %
Rrushi	4 891	6.7	32 770	21 445		11 325	153 %
Pemët	4 542	16.0	72 672	249 817	177 145		29 %
Perimet	21 500	7.0	150 500	292 000	141 500		52 %

Burimi, MBPZHR, 2004

Situatë e ngjashme është edhe në sektorin e blegtorisë, i cili ka qenë njëri ndër sektorët më të dëmtuar gjatë luftës. Edhe pse ky sektor është ndihmuar mjaft shumë pas luftës, ai ende as për së afërmi nuk është në gjendje t'i përmbushë nevojat e tregut vendës. Mungesa e masave stimulative (subvencioneve, kreditimit në kushte të favorshme, etj.), nga njëra anë dhe stimulimi i kësaj prodhimtarie në disa nga vendet fqinje e ka vënë në pozitë shumë të pafavorshme bujqësinë e Kosovës.

5.2 Sipërfaqet punuese dhe struktura e prodhimit në bujqësi

Kosova posedon 577.000 ha tokë bujqësore⁵. Nga kjo sipërfaqe (sipas të njëjtit burim), vetëm 272.040 ha (47.1 %) janë toka të mbjellura me bimë të ndryshme, ndërsa pjesa tjetër është me livadhe, kullosa dhe djerrina. Nga sipërfaqet e mbjellura dominojnë drithërat. Nga tërë këto sipërfaqe 88.6 % është në pronësi private.


Si rezultat i mungesës së mbrojtjes institucionale të tokës bujqësore, ajo i është nënshtruar një shfrytëzimi shumë të madh për nevoja të tjera. Kjo ka bërë që sipërfaqet me tokë bujqësore të zvogëlohen në vazhdimësi. Është nevojë urgjente që toka bujqësore të mbrohet me ligj dhe të caktohen tokat që janë të destinuara vetëm për tokë bujqësore. Kjo do të ndikonte që të ulet çmimi i tokës bujqësore dhe do ta mbronte atë nga shkatërrimi i mëtejshëm.

Gjithashtu edhe sipërfaqet pyjore i janë nënshtruar dëmtimit të vazhdueshëm (përmes prerjes së pakontrolluar të tyre). Andaj edhe për sipërfaqet pyjore duhet udhëhequr politikë e njëjtë, me qëllim të mbrojtjes së tyre nga shkatërrimi i mëtejshëm.

Sipas rezultateve të anketës me familjet rurale, madhësia mesatare e fermës për familjet rurale është 2.36 ha, ndërsaq mesatarja e tokës bujqësore për familje 2.01 ha, e cila është e shpërndarë mesatarisht në 3.4 parcela. Nga sipërfaqja bujqësore 0.72 ha janë livadhe dhe kullosa. Në bazë të këtyre të dhënave mund të thuhet se toka që punohet është mesatarisht 1.29 ha për familje.

Madhësia e pronës paraqet një tregues të rëndësishëm të gjendjes materiale të popullsisë e cila mirret me bujqësi dhe jeton kryesisht prej saj. Shumica e familjeve rurale kanë ferma të vogla; 40.2 % kanë ferma 0.1-1.0 ha, 24.4 % kanë ferma 1-2 ha, 25.3 % 2-5 ha dhe rreth 8 % mbi 5 ha. Rreth 2 % e familjeve rurale nuk kanë tokë bujqësore.

⁵ MBPZHR, 2004



Burimi: Anketa me familje, Riinvest, 2004

Pra, ekonomi familjare me më shumë se 5.0 ha tokë bujqësore janë rreth 8 %, që paraqet një shtresë shumë të hollë të ekonomive, të cilat mund të ishin prodhues më të sigurt dhe më të mëdhenj bujqësor.

Madhësia e vogël e fermës është njëri nga faktorët kufizues për një prodhimtari intensive bujqësore. Duke qenë në një situatë të këtillë fermerët të cilët janë të orientuar nga prodhimi komercial shpeshherë janë të detyruar që të marrin tokë me qira (8.9 %).

Në një situatë të këtillë, kur sipërfaqet e tokës bujqësore janë shumë të kufizuara, rritja e produktivitetit (rritja e rendimentit për njësi të sipërfaqes) në to është mundësi reale për një prodhim i cili në të ardhmen e afërt duhet të orientohet në zëvendësimin e importit të produkteve bujqësore. Natyrisht se duhet hulumtuar në vazhdimësi mundësitë e eksportit për ato prodhime të cilat Kosova ka mundësi t'i eksportoje.

Tabela 11: Tregues të rëndësishëm të fermës

Madhësia mesatare e fermës (ha)	2.36
Madhësia mesatare e tokës bujqësore (ha)	2.01
Livadhe dhe kullosa (ha)	0.72
Tokë që punohet (ha)	1.30
Numri mesatar i parcelave për familje	3.4
Numri i fermerëve që marrin tokë me qira (%)	8.9
Çmimi mesatar i qirasë €/ha	542.0


Burimi: Anketa me familje, Riinvest, 2004

Madhësia e fermës në Kosovë është për disa herë më e vogël se ajo që është në nivelin e Bashkësisë Evropiane. Prona mesatare në BE në vitin 1997 ishte 18.4 ha me variacione mes 4.3 ha në Greqi dhe 69.3 ha në Britani të Madhe. Madhësinë mesatare nën 10 ha e kanë pasur Italia (6.4 ha) dhe Portugalia (9.2 ha), mbi 10 ha e kishin Austria (16.3 ha)

dhe Holanda (18.6 ha), kurse mbi 20 ha Belgjika dhe vendet tjera të BE-së. Pronat mesatare mbi 40 ha i kanë arritur Franca (41.7 ha), Danimarka (42.6 ha), Luxemburgu (42.5) dhe Britania e Madhe (69.3 ha).

Rezultatet e anketës tregojnë se në strukturën e të mbjellave dominojnë drithërat me 41 %. Pastaj vijnë livadhet dhe kullosat me 32 %. Sipërfaqet me perime janë 6 %. Edhe sipërfaqet me vreshta dhe pemë janë mjaft të vogla (1, përkatësisht 3 %). Është mjaft shqetësues fakti se 13 % e tokës së punueshme në sektorin privat, nuk punohet fare. Kur këtij fakti i shtojmë edhe të dhënë se shumica e tokës në sektorin shoqëror (e cila nuk është e privatizuar dhe e cila përbën rreth 12 % të tokës bujqësore në nivel të Kosovës), nuk punohet, mund të vërehen edhe më qartë përmasat e këtij problemi. Gjithashtu është shqetësues fakti se këto sipërfaqe mund të jenë edhe më të mëdha në vitin e ardhshëm, pasi që 16.8 %, e të anketuarve deklarojnë se nuk do ta punojnë tokën në këtë vit. Arsyt kryesore që përmenden për këtë janë: nuk sjell fitim, e më rrallë punësimi diku tjetër dhe burimi tjetër i të ardhurave. Megjithatë në kushtet kur sipërfaqet me tokë të punueshme në Kosovë janë mjaft të kufizuara, nga njëra anë, dhe duke pasur parasysh deficitin e madh të vendit në prodhime bujqësore, kjo përqindje paraqitet si mjaft shqetësuese.

Fig. 4. Struktura e tokës bujqësore në sektorin privat



Burimi: Anketa me familje, Riinvest, 2004

5.3. Fondi blegtoral

Fondi blegtoral në Kosovë, sidomos gjatë luftës, është varfëruar shumë. Disa të dhëna flasin se 50 % e bagëtisë është humbur gjatë luftës. Disa donatorë kanë ndihmuar ripërtëritjen e fondit të bagëtisë dhe deri në tremujorin e parë të vitit 2003 me 10.000 mëshqerra të mbarësuar, të cilat janë importuar dhe u janë shpërndarë fermerëve në viset rurale⁶. Edhe pse në këtë drejtim ka pasur donacione nga organizata të ndryshme, megjithatë ky fond është ende mjaft i varfër. Nga të dhënat e anketës vërehet se vetëm 67.71 % e familjeve rurale mbajnë lopë qumështore, apo 1.2 krerë për familje. Edhe me bagëtitë tjera situata është e ngjashme.

⁶ MBPZHR, Libri i Gjellbër i Kosovës

Të dhënat mbi përqindjen e familjeve që mbajnë bagëtitë përkatëse dhe numri mesatar i bagëtive për familje janë të paraqitura në tabelën në vazhdim:

Tab. 12. Të dhëna për bagëtitë në sektorin privat

Lloji i bagëtisë	Pjesëmarrja e familjeve që mbajnë bagëti (%)	Numri mesatar i bagëtive për familje
Lopët qumështore	67.7	1.2
Gjedhat	29.7	0.6
Delet*	2.2	1.6
Pulat	56.3	9.6
Dhitë	2.2	0.1
Kuajt	5.9	0.1
Derrat	8.9	0.6

* Një fermer i ka 443 dele, që paraqet mbi gjysmën e deleve të përfshira në anketë
Burimi: Anketa me familje, Riinvest, 2004

Me një fond të këtillë blegtoral familjet rurale në disa raste nuk arrijnë t'i plotësojnë as nevojat vetanake. Kushtet mjaft të favorshme për sektorin e blegtorisë nuk janë të shfrytëzuara as për së afërmi. Këto të dhëna flasin për mundësitë shumë të kufizuara të këtyre fermerëve për të prodhuar për treg. Konsiderohet që në këtë sektor janë hapësirat më të mëdha për zhvillim.

5.4. Rendimentet e kulturave bujqësore

Rendimentet e kulturave bujqësore në Kosovë, marrë në përgjithësi, janë shumë të ulëta në krahasim me potencialet gjenetike të kulturave që sot kultivohen tek ne, si dhe në raport me vendet tjera evropiane.

Edhe pse tek disa kultura ka tendencë të rritjes së rendimenteve, megjithatë në këtë drejtim situata është shqetësuese.

Tab. 13. Rendimentet e kulturave kryesore bujqësore për vitin 2003

Kultura bujqësore	Rendimenti (t/ha)
Gruri	3.0
Misri	3.6
Patatja	13.4
Domatja	15.5
Speci	9.5
Qepa	6.0

Burimi: MBPZHR, 2004

Në krahasim me vendet tjera këto rendimente janë madje disa herë më të ulëta. Në vendet e Evropës Perëndimore rendimenti mesatar i grurit sillet nga 7.5 – 8.2 t/ha, i misrit 8-10 t/ha, i patates 36 – 50 t/ha, etj. Ngjashëm është situata edhe me kulturat tjera.

Faktorët kryesorë që kanë ndikim në këtë janë mjaft kompleks. Madhësia e fermës, njohuritë e mangëta të fermerëve në lidhje me aplikimin e masave të reja agroteknike, përdorimi i farës jociësore për mbjellje, kostoja e lartë e prodhimit, mungesa e masave stimulative për fermerët, konsiderohen disa nga shkaqet kryesore të rendimenteve kaq të ulëta.

5.5 Tregu i produkteve bujqësore

Shumica e fermave në Kosovë janë të orientuara në rend të parë të prodhojnë për nevojat e familjes. Nga të dhënat e anketës del se prodhimi bujqësor shfrytëzohet për përdorim vetanak prej 73 % te perimet deri 96 % te pemët. Në një situatë të këtillë mundësitë e plotësimit të nevojave të tregut vendës me prodhime bujqësore janë mjaft të kufizuara. Faktorët që ndikojnë në një orientim të këtillë të fermave janë të shumtë: fermat e vogla, kostoja shumë e lartë e prodhimit, mospërshtatja e prodhimit kërkesave të tregut, mungesa e mjeteve financiare për investime etj.

Tab. 14. Pjesëmarrja e prodhimit blegtoral për konsum vetanak dhe për treg

Bagëtitë	Përqindja e prodhimit	
	Për përdorim vetanak apo në fermë (%)	Shitje me para të gatshme (%)
Lopët qumështore	89.9	10.1
Gjedhat	76.3	23.7
Delet	52.0	48.0
Pulat	94.5	5.5
Dhitë	90.9	9.1
Kuajt	99.7	0.3
Derrat	72.5	27.5

Burimi: Anketa me familje, Riinvest, 2004

Tab. 15. Pjesëmarrja e prodhimit bimor për konsum vetanak dhe për treg

Prodhimi bimor	Përqindja e prodhimit	
	Përdorimi në fermë (%)	Për shitje (%)
Drithëra	90.7	9.3
Perime	73.4	26.6
Livadhe	89.8	10.2
Vreshta	82.6	17.4
Pemishte	96.6	3.4
Pyje	94.2	5.8

Burimi: Anketa me familje, Riinvest, 2004

Fermt e vogla mesatarisht nuk i plotësojnë as nevojat e familjes për shumicën e prodhimeve bujqësore. Plotësimi i nevojave të familjeve rurale me produkte bujqësore është rreth 70 %. Në tabelën e mëposhtme janë dhënë vlerat mesatare për ata që prodhojnë këto prodhime bujqësore.

Tab. 16. Plotësimi i nevojave të familjeve rurale me produkte bujqësore (%)

Produktet bujqësore dhe blegtorale që kultivohen në fermë	Familjet rurale që i kultivojnë produktet përkatëse (%)	Niveli i plotësimit të nevojave (%)	Mesatarja e përgjithshme e plotësimit të nevojave të familjeve rurale (%)
Produkte drithi dhe misri	70.1	73.5	51.5
Perime	56.1	61.1	34.3
Fruta pemësh	27.9	49.7	13.9
Prodhime qumështi	67.7	90.3	61.1
Vezë	56.3	72.0	40.5
Mish	39.7	63.8	25.3

Burimi: Anketa me familje, Riinvest, 2004

Shitja e produkteve bujqësore nga ana e familjeve rurale bëhet kryesisht në tregjet lokale. Fermerët vet e bëjnë shitjen e produkteve të tyre (87.6 %). Vetëm 2.8 % e fermerëve shitjen e bëjnë me ndihmën e shoqatës apo kooperativës. Burimet kryesore të informimit të fermerëve për çmimet e produkteve bujqësore të cilat dëshirojnë t'i shesin janë shumë të pasigurta. Vetëm rreth 10 % e fermerëve interesohen që të marrin informata për çmimet dhe kushtet tjera në treg, nga shoqatat e prodhuesve, kooperativat apo mjetet e informimit. Pjesa më e madhe e tyre shfrytëzojnë informatat nga fermerët tjerë dhe nga shitësit me shumicë.

Tab. 17. Burimet kryesore prej nga informohen fermerët për çmimet e produkteve bujqësore të cilat dëshirojnë t'i shesin (%)

Fermerët e tjerë	27.2
Shoqatat e prodhuesve	3.7
Kooperativat	2.5
Shitësit me shumicë	13.6
Radioja	4.3
Tjetër (nga askush)	42.6
Pa përgjigje	6.2
Totali	100.0

Burimi: Anketa me familje, Riinvest, 2004

Tab. 18. Burimet e ndihmave për shitjen e produkteve bujqësore

	%
Kooperativat	1.4
Shoqatat e prodhuesve	1.4
Grupet joformale të fermerëve	3.4
Asnjë, çdoherë i shes produktet vet	87.6
Tjetër	6.2
Total	100.0

Burimi: Anketa me familje, Riinvest, 2004

Për shkak të mosorganizimit të tyre (p.sh. në shoqata), fermerët nuk janë në gjendje që secili individualisht t'i përshtaten më mirë kërkesave të tregut. Bujqit vendës pothuajse e kanë të pamundur të futen në tregun me shumicë në Prishtinë. Kjo ndodh për arsye se vendet për shitje i paguhen ndërmarrjes që e menaxhon tregun për gjithë vitin nga ana e tregtarëve të cilët kryesisht janë importues nga jashtë të prodhimeve bujqësore, të cilat i shesin në tregun me shumicë. Fermerët vendës nuk kanë qenë në gjendje që në mënyrë më të vendosur të angazhohen në këtë drejtim, për të bërë presion tek Ministria apo pushteti lokal, në mënyrë që atyre t'ju sigurohet vend më i përshtatshëm për shitjen e prodhimeve të tyre. Gjithashtu, me qasjen e tanishme që fermerët kanë ndaj tregut ata nuk janë në gjendje të hulumtojnë apo eventualisht të gjejnë tregje të reja.

6. PARAKUSHTET DHE POLITIKAT E ZHVILLIMIT MODERN RURAL

6.1. Rritja e eficiencës ekonomike dhe përmirësimi i strukturës së prodhimit bujqësor

Ristrukturimi i prodhimit bujqësor është i domosdoshëm duke marrë parasysh se, gjykuar në resurset dhe mundësitë objektive të fermerëve, Kosova ka vështirësi të theksuara konkurrencte në tregun e vendit e aq më tepër në eksport. Gjithashtu, për shkak të mundësive të vogla për investime dhe rregullave të tregtisë së lirë, kufizohen mundësitë që aftësia konkurruese të mbrohet përmes subvencioneve dhe tarifave më të larta.

Në bazë të të dhënave nga anketa, por edhe nga burime të tjera, vërehet se mënyra e prodhimit është ende shumë tradicionale, që karakterizohet me rendimente të ulëta, karakter të theksuar sezonal të prodhimit (te perimet) dhe vështirësi të tjera. Për këtë arsye duhet gjetur forma më efikase të komunikimit me fermerë, në mënyrë që ata të jenë në gjendje që të arriturat e reja në teknologjinë e prodhimit bujqësor t'i aplikojnë në fermat e tyre.

Organizimi më i mirë i fermerëve në shoqata do t'ju mundësonte atyre që të shfrytëzojnë më mirë benificionet që ata mund t'i kenë nga anëtarësimi në shoqata.

Bazuar në kushtet natyrore, në traditën dhe mundësitë për ndërtimin e konkurrencës, është e nevojshme që të zgjidhen sektorët të cilët do të kenë përparësi, siç janë blegtoria (prodhimi dhe përpunimi i mishit dhe qumështit), bimët për ushqimin e kafshëve dhe sektori i perimeve dhe pemëve. Këta sektorë paraqiten mjaft të rëndësishëm, në rend të parë për substituimin e importit, pasi që sasi e madhe e këtyre produkteve importohet nga vende të ndryshme (kryesisht nga vendet fqinje). Në anën tjetër, ekzistojnë resurse mjaft të favorshme natyrore për avancimin e prodhimtarisë në këta sektorë. Zhvillimi i këtyre sektorëve do të ishte shtytës mjaft i rëndësishëm edhe për zhvillimin e industrisë përpunuese (pasi që shumica e produkteve të përpunuara në këta sektorë gjithashtu importohen). Krijimi i një ambienti më të favorshëm për stimulimin e fermerëve, kreditimi me kushte të favorshme, ngritja profesionale e fermerëve, do të ishin vetëm disa nga masat që do ta stimulonin prodhimin në këta sektorë.

Nëpërmjet një programi të masave konzistente, që përfshijnë sidomos asistencën teknike dhe financiare, nevojitet që këta sektorë të stimulohen në zhvillimin e tyre, duke pasur parasysh edhe industrinë përpunuese ushqimore.

6.2 Politika fiskale, tregtare dhe subvencionet në bujqësi

Politika fiskale e zbatuar pas luftës është konsideruar jo shumë e volitshme nga fermerët dhe ata që bëjnë pjesë në agroindustri. Reformimi i saj është konsideruar si një nga parakushtet për zhvillim të sektorit dhe inkurajim të investimeve në bujqësi. Janë mirëpritur ndryshimet e hyra në fuqi në qershor 2004, të cilat sigurojnë heqjen e taksës doganore për inputet bujqësore dhe për pajisje. Fermerët kërkojnë hapa të mëtejshëm për rishqyrtimin e zbatimit të TVSH-së për inpute, mekanizim bujqësor dhe teknologji moderne, në mënyrë që të sigurohen kushte të barabarta ekonomike me vendet fqinje. Me këtë do të kompensohej mungesa e subvencioneve, për çka buxheti i Kosovës ka mundësi të kufizuar.

Deri tani politika fiskale lineare, me taksë të njëjtë 10 % dhe TVSH 15 %, ka sjellë vështirësi në zhvillimin e prodhimit vendës të ushqimit dhe ka favorizuar importin. Politika fiskale në vendet që konkurrojnë me Kosovën, është në favor të prodhuesve bujqësorë të atyre vendeve, në kushtet kur shteti subvencionon drejtpërdrejt fermerët. Në vendet konkurrencte janë vënë tarifa të larta për prodhimet që konkurrojnë prodhimet vendëse me doganë 20-30 % dhe doganë të ulët për inpute, mekanizim bujqësor dhe teknologji bashkëkohore, që ndihmon në koston e ulët të prodhimit dhe çmimet mbahen të ulëta. Pasi që Kosova nuk ka mundësi të subvencionimit të prodhimit vendës, politika fiskale dhe tregtare mbetet si zgjidhje e vetme. Po ashtu, duhet shqyrtuar vënien e kuotave sezonale dhe licencave që të kufizohet furnizimi nga importi i prodhimeve që me cilësi të lartë dhe çmim konkurrues mund të prodhohen në vend.

Qeveria e Kosovës varet shumë nga taksat e grumbulluara në kufi, që përbëjnë mbi 80 % të taksave të përgjithshme. Në shumë vende të rajonit shteti mbështet financiarisht prodhuesit dhe përpunuesit bujqësorë. Subvencionimi i kamatave të kredive është mjaft i përhapur në shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Disa nga shtetet kanë programe speciale për modernizimin e prodhimtarisë bujqësore, ku jipet një fond garantues që mbështet bankat private për kreditim të prodhuesve që nuk kanë hipotekë. Shumë shtete në tranzicion si Estonia, Lituania, Bullgaria, Rumania etj., kanë programe investive në bujqësi me kredi afatshkurtëra për blerjen e farës së certifikuar, plehut dhe pesticideve e sidomos pas vitit të vështirë (të thatë) në prodhimtarinë bujqësore. Programet tjera afatgjata janë për blerjen e mekanizmit bujqësor, gjedheve me potencial të lartë, për ngritjen e plantazheve të pemëve dhe vreshtave. Rumania në vitin 2001 ka filluar me një program mbështetës të prodhuesve dhe përpunuesve bujqësorë, ku mjetet që janë dedikuar për këtë qëllim janë mbledhur nga privatizimi i fermave shtetërore. Ky program është bazuar kryesisht në blerjen më lirë të mekanizmit dhe pajisjeve prodhuese (prodhuesi ka paguar vetëm 50 % të vlerës).⁷

Edhe në Kosovë, një formë e preferuar e mbështetjes financiare do të ishte dhënia e kredive për prodhuesit dhe përpunuesit bujqësorë, duke subvencionuar normën e interesit të kredisë. Kjo nënkupton që vendimi për dhënien e kredisë dhe zgjedhja e përfituesve të mbetet përgjegjësi e bankës. Shembuj të tillë kemi në disa shtete të Evropës Qendrore dhe Lindore, ku huamarrësit paguajnë një të tretën e kamatës bankës private, ndërsa dy të

⁷ Agricultural Policies in Transition Economies – Trends in Policies and Support. Raport i OECD-së, 2002.

tretat e kamatës bankës i kompensohet nga buxheti i qeverisë. Ky program në disa shtete është treguar mjaft i suksesshëm, si në Rusi, ku është rritur shumë kreditimi i prodhuesve dhe përpunuesve bujqësorë dhe kthimi i kredisë ka qenë në një shkallë mjaft të lartë, 98.5 %.⁸

6.3 Infrastruktura rurale

Ekzistenca e një infrastrukture të përshtatshme mund të konsiderohet si një nga faktorët më të rëndësishëm për zhvillimin rural në Kosovë. Ajo i shërben shumë qëllimeve, si përmirësimit të kushteve të jetesës, sigurimit të qasjes në tregje, përmirësimit të prodhimit bujqësor si dhe thithjes së investimeve.

Përmirësimi i përgjithshëm i kushteve të jetës mund të arrihet vetëm me një infrastrukturë rurale të zhvilluar, por jo vetëm kaq. Infrastruktura rurale është edhe parakusht esencial për rritjen e prodhimtarisë bujqësore, rritjen e aftësisë konkurruese, si dhe rritjen e profitabilitetit dhe, në përgjithësi, për krijimin më të madh të të ardhurave, që ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e standardit jetësor. Duke pasur infrastrukturë rurale të zhvilluar, në Kosovë pengohet edhe fenomeni shqetësues i migrimit nga viset rurale drejt atyre urbane, sepse qasja në tregje është shumë më e lehtë, si dhe zvogëlimi i diferencave ndërmjet fshatit dhe qytetit shkon çdoherë duke u zvogëluar e me këtë edhe motivi i migrimit.

Faktorët që do të duhej përmendur këtu janë:

Rrugët – Vendbanimet rurale në përgjithësi e ato kodrinore malore në veçanti karakterizohen me mungesë të madhe të infrastrukturës rrugore. Në fakt kjo paraqitet si njëri nga faktorët më limitues në rritjen e prodhimtarisë bujqësore, në njërën anë, si dhe një nga faktorët vendimtarë që determinojnë vendimin për ta braktisur fshatin, duke pasur parasysh transportin e vështirësuar dhe ofertën shumë të varfër të shërbimeve. Kjo mungesë ndikon edhe në pengimin e qasjes në shërbimet tjera themelore, siç janë arsimi, kultura dhe shëndetësia.

Mungesa e burimeve financiare – buxhetore dedikuar infrastrukturës rurale është shumë e madhe. Burimet financiare për këto investime janë shumë të pakta, por po ashtu është e vogël edhe rëndësia që i jipet zhvillimit të bujqësisë në viset rurale. Disa donatorë kanë investuar në ndërtimin e rrugëve, e në shumë raste edhe iniciativat e komunitetit kanë zgjedhur problemet e mëdha të kësaj natyre. Mirëpo, kjo është vetëm njëra anë e problemit; ana tjetër, që është mjaft brengosëse, është ajo se edhe rrugët ekzistuese nuk mirëmbahen nga askush, kështu që efektet e investimeve nuk janë të qëndrueshme. Problemi i transportit rrugor duhet të shikohet si një nga çështjet kyçe të zhvillimit të viseve rurale, kështu që kjo çështje duhet të trajtohet me prioritet.

Uji - Në viset rurale të Kosovës sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm është në gjendje shumë të rëndë. Një numër vendbanimesh që gjinden bri rrugëve magjistrale apo afër

⁸ Po aty.

qyteteve të mëdha janë të lidhura me sistemet e ujësjellësit publik. Në shumë fshatra janë ndërtuar me vetëkontribut sisteme të vogla të ujësjellësve lokalë, cilësia e të cilëve nuk kontrollohet. Por, numri më i madh i ekonomive familjare furnizohet me ujë nga puset, me kualitet të ujit të dyshimtë dhe të dobët.

Në bazë të studimeve, mbi 50 % e popullsisë përdor ujin për pije i cili nuk i plotëson kushtet elementare të kualitetit. Aktualisht, kompanitë e ujësjellësit janë të organizuara në nivel rajonal dhe atë komunal, kurse çmimet e shërbimit përcaktohen nga këto kompani pa ndërhyrje nga Qeveria.

Kanalizimi - Është karakteristikë se në të kaluarën investimet publike në ndërtimin e sistemeve të kanalizimit në viset rurale kanë qenë shumë të vogla, për të mos thënë se nuk ka pasur fare. As sot gjendja nuk është e mirë. Higjiena është në nivel të ulët, shpeshherë kanoset rreziku i sëmundjeve ngjitëse. Shërbimet e grumbullimit të mbeturinave nuk ekzistojnë, andaj ekonomitë familjare gjenden si munden, duke shpërndarë mbeturinat aty-këtu, duke ndotur ambientin.

Energjia elektrike - Furnizimi me energji elektrike është vështirësuar sidomos pas vitit 1999 dhe nga kjo kanë pësuar jo vetëm viset rurale, por edhe ato urbane. Përndryshe, edhe pse të gjitha vendbanimet rurale janë të elektrifikuara prej kohësh, problemi kryesor qëndron në vjetërsimin e sistemeve të distribuimit të rrymës dhe në kapacitetet e tyre të ulëta. Pas përfundimit të luftës ka pasur një investim të donatorëve në këtë drejtim, sidomos në komunat e Kosovës Qendrore.

Është me rëndësi të posaçme furnizimi me energji elektrike, sepse ai paraqitet si faktor kufizues në aktivitete agropërpunuese, por edhe në biznese të tjera në të gjitha kompanitë. Situata e vështirë me energjinë elektrike ka kushtëzuar të gjithë biznesmenët që, për të pasur prodhim të sigurt, të orientohen në burime të tjera alternative të energjisë, si p.sh. agregatët, gjë që ka shtrenjtuar investimet dhe ka ngritur koston e prodhimit, duke zvogëluar kështu profitabilitetin.

Sistemet e ujitjes - Sistemet e ujitjes në Kosovë paraqiten si faktorë kufizues në prodhimtarinë bujqësore. Ekziston deficit i ujit, që ndikon në produktivitetin dhe në profitabilitetin e fermerëve.

Pas luftës, investimi me i madh në aftësimin dhe në rehabilitimin e sistemit të ujitjes është bërë nga Agjencioni Evropian i Rindërtimit. Kjo ka përfshirë aftësimin e kanaleve primare të ujitjes dhe të objekteve të tjera kapitale. Financimi përfshin një shumë prej rreth 12 milionë euro. Mirëpo, problemi qëndron në aftësimin e kanaleve sekondare dhe terciare, të cilat në fakt e përcjellin ujin deri te fermeri. Pa aftësimin e këtyre kanaleve nuk mund të flitet për një sistem efikas të ujitjes. Përndryshe, sistemet e ujitjes janë më tepër të përhapura në fshatrat e rajonit të Dukagjinit, ku ekziston një traditë e konsiderueshme në këtë drejtim. Është shumë e nevojshme që të vazhdojnë investimet në rehabilitimin dhe në mirëmbajtjen e sistemeve ekzistuese të ujit. Edhe pse mundësitë e buxhetit të Kosovës janë shumë të kufizuara, duhet marrë në konsideratë investimet publike për zhvillimin e mëtutjeshëm të sistemit të ujitjes dhe të prodhimtarisë bujqësore në përgjithësi.


Nga këto hidrosisteme në Kosovë në vitin 2003 janë ujitur 15.563 ha. Nga burimet tjera (puset, lumenjtë, etj.) llogaritet se janë ujitur 5000 ha (MBPZHR, Raporti mbi rehabilitimin e sistemeve të ujitjes, 2003). Në vitin 2004, parashikohet që këto sipërfaqe të rriten në rreth 24000 ha.

Nga të dhënat e anketës me familjet rurale del se rreth 66 % e familjeve të anketuara deklarojnë se nuk kanë mundësi fare të ujisin tokën e tyre, ndërkaj 34 % kanë mundësi që pjesërisht t'i ujisin sipërfaqet e tyre. Nga të dhënat e përgjithshme vërehet se vetëm 16 % e sipërfaqeve të përgjithshme punuese ka mundësi të ujitjen. Në rajonet të cilat nuk janë të mbuluara me hidrosistem, ujitja me pompa të ndryshme e rrit koston e prodhimit.

Pas përfundimit të luftës në Kosovë ka një riorganizim në menaxhimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të shpërndarjes së ujit.

Tash në Kosovë ekzistojnë tri kompani të ujitjes. Është futur koncepti i ri. Tashmë kanë filluar të krijohen shoqatat e përdoruesve të ujit. Në disa vise rurale, sidomos në Dukagjin, ekziston një përvojë dhe traditë e gjatë në ujitje, edhe pse sistemet e ujitjes janë të vjetra. Kanalet për ujitje, duke iu falënderuar disa investimeve të donatorëve, janë duke u mirëmbajtur. Kjo është një çështje me rëndësi që meriton të vazhdohet më tutje dhe zgjidhja e tillë të bëhet edhe më efektive.

Fig. 5. Sipërfaqet e ujitura në sektorin privat



Zhvillimi i qëndrueshëm rural në Kosovë nuk mund të paramendohet pa një zhvillim të përgjithshëm dhe të fuqishëm të infrastrukturës rurale. Është evidente se kjo nuk mund të bëhet pa mbështetje financiare buxhetore. Edhe pse nevojat dhe prioritetet buxhetore në Kosovë janë të shumta, është shumë e nevojshme që të rritet vetëdija te projektuesit buxhetorë se investimet më të mëdha buxhetore për infrastrukturën rurale vendosin themelet për zhvillimin e përgjithshëm rural e sidomos të bujqësisë.

6.4 Financimi dhe kreditimi në zonat rurale

Si shumë vende të tjera në tranzicion, edhe Kosova përballlet me shumë sfida që pamundësojnë një vëllim të favorshëm të kreditimit për sektorin e bujqësisë. Burimet kryesore për financim të sektorit të bujqësisë janë kryesisht bankat komerciale, institucionet financiare si ABU dhe disa institucione të tjera mikrofinanciare. Format tjera të huazimit janë ato nga anëtarët e familjes dhe shokët, financimet nga përpunuesit, nga tregtarët e inputeve bujqësore për një kohë të shkurtër, si te tregtarët më të vegjël ashtu edhe te fermerët.

Kreditimi i bujqësisë është jotërheqës dhe me një shkallë të lartë rreziku për bankat komerciale që aktualisht veprojnë në Kosovë. Kamatat janë të larta dhe shumë vështirë mund të kthehen nga fermerët.

Vitin e fundit ka pasur një rritje të rëndësishme të kreditimit të përgjithshëm të të gjitha bankat, por pjesëmarrja e bujqësisë vazhdon të mbetet shumë e vogël, rreth 2 %⁹. Agrobiznesi ka përfituar më së shumti, fermat e gjedheve dhe të shpendëve, përpunuesit e produkteve bujqësore, tregtarët e inputeve bujqësore, si dhe fermerët, për blerjen e serrave. Shumë pak është kredituar fermeri që merret me mbjelljen e kulturave bujqësore si grurë, misër dhe perime në fusha të hapura.

Bankat komerciale, kryesisht ato me aksionarë vendës, kanë rritur kreditimin në sasi të vogël të kredisë, deri në vlerë € 5,000, ku procedura e marrjes së kredisë është e thjeshtë, nuk nevojitet plan biznesi dhe hipotekë. Kryesisht këto janë kredi afatshkurtëra, deri 12 muaj, për konsumatorë, që ndihmojnë pak sektorin e bujqësisë. Kamatat që bankat dhe institucionet tjera financiare ofrojnë janë të ndryshme dhe sillen nga 8-10 % në vit, për 1-3 vite tek ABU e deri në 24 % në vit te PCB. Shumica e bankave me aksionarë vendës ofrojnë kamatë vjetore rreth 15 %.

Rezultatet e anketës tregojnë se vetëm 5.7 % e familjeve të anketuara në viset rurale kanë qenë të ngarkuara me kredi, ndërsa në vendet urbane rreth 10.3 %. Në fshatra rreth 64 % të kredive të akorduara kanë qenë me afat të kreditimit deri në 1 vit, derisa në qytete 46 %. Shumica e kredive janë nën 5,000 €, në fshat 77 % të tyre, në qytet 57 %. Nga këto të dhëna shihet edhe qasja e pafavorshme e zonave rurale në absorbimin e kredive në krahasim me zonat urbane. Përveç kësaj, vetëm 19 % e kredive të lejuara familjeve në zonat rurale janë shfrytëzuar për bujqësi.

Tab.19. Diferencat në kreditim mes familjeve rurale dhe urbane

	Rurale	Urbane
Kreditimi i përgjithshëm	5.7 %	10.3 %
Afati i kthimit deri 1 vit	64 %	46 %
Mbi 1 vit	36 %	54 %
Shuma deri 5,000 €	77 %	57 %
Mbi 5,000 €	23 %	43 %

Burimi: Anketa me familje, Riinvest, 2004

⁹ BPK, Monthly Statistics Bulletin, March 2004

Shkalla e ulët e kreditimit është edhe si pasojë e pamundësisë së sektorit të bujqësisë që të kthejë kredinë nga problemet e shumta në këtë sektor e disa nga ato janë:

- konkurrenca e prodhimeve të lira nga vendet e rajonit,
- aplikimi i teknologjive tradicionale në prodhim dhe njohuritë jo të mjaftueshme rreth marketingut të produkteve,
- politika jo e favorshme fiskale që ngarkon mjaft prodhimtarinë vendëse,
- mosmbajtja e evidencës financiare nga ana e fermerëve dhe përpunuesve bujqësorë, çka kërkohet nga bankat por njëherit janë edhe të domosdoshme për menaxhimin e fermës,
- jo të gjithë kërkuesit e kredisë e kanë të qartë si ta përdorin atë apo janë shumë ambiciozë me programet e investimeve të tyre. Disa fermerë kanë problem me shitjen e prodhimeve në nivel të prodhimit që kanë, në njërën anë, ndërsa në anën tjetër kërkojnë kredi për rritjen e prodhimtarisë.

Të gjitha bankat për shuma më të larta të kredive kërkojnë hipotekë, që zakonisht sillet prej 150 deri 250 % të vlerës së kredisë. Në praktikë problem në vete është caktimi i vlerës së hipotekës dhe shpeshherë bankat kërkojnë 2-4 herë vlerë më të lartë të hipotekës se ajo e kredisë. Për bankat është shumë më tërheqëse hipoteka rrjedhëse që në të shumtën e rasteve fermerët nuk e posedojnë. Fermerët kryesisht mund të ofrojnë tokën si hipotekë. Sipas anketës, 76 % e fermerëve janë në gjendje ta bëjnë këtë.

Për një kohë të gjatë pas luftës vepron Njësia për Agrobiznes (ABU), e financuar nga AER-i, që ka kredituar disa agropërpunues dhe ferma të gjedheve dhe viçave për majmëri me kredi afatgjata deri në pesë vite dhe kamata të volitshme 7-10 % dhe gjashtë muaj grejs-periudhë. Mungesë e këtij programi është përfshirja e një numri të vogël të përfituesve për arsye të limitit të lartë të kreditimit, mbi € 200 mijë, dhe shkallë të ulët të kthimit të kredisë. Po ashtu, një program mjaft të rëndësishëm ka realizuar Organizata Katolike për Ndihmë dhe Zhvillim (CORDAID), me kreditim me kamata shumë të volitshme të tregtarëve të inputeve bujqësore, shpendtarëve dhe fermerëve të nënsektorëve të tjerë. Njëjtë si ABU, edhe ky program karakterizohet me një kthim jo të kënaqshëm të kredisë nga huamarrësit.

Programet mikrofinanciare kanë qenë mjaft prezente në periudhën e pasluftës, të themeluara nga OJQ-të ndërkombëtare dhe ato lokale, që kryesisht kanë mbështetur bizneset e vogla, grupet minoritare dhe gratë me kapacitet për gjenerim të mjeteve, ku zonat rurale kanë përfutur mjaft. Nga këto programe mund të përmendim Njësinë e Përkohshme Kreditore (ICU), FINCA, ADIE – Internacional, Agjencioni për Financim në Kosovë (AFK), Besëlidhja-Mikrofinanca etj.

Arsye tjetër për një proces të ngadalshëm të kreditimit në bujqësi është edhe përvoja jo e mjaftueshme e bankave, si dhe mosbesimi të klientët e rinj, që kryesisht do të jenë nga zonat rurale. Disa kredi të marra për investime në bujqësi janë harxhuar për destinime të tjera. Nga anketa del se rreth 42 % e fermerëve destinim primar të kredisë kanë pasur shpenzimet e përditshme dhe blerjen e pajisjeve. Mundësi më të mirë për marrje dhe kthim të kredisë kanë prodhuesit bujqësorë komercialë, që kryesisht kanë filluar veprimtarinë në pronat bujqësore publike dhe në tokën e kombinateve dhe kooperativave bujqësore. Këta prodhues (fatmirësisht numri i tyre po rritet për çdo ditë)

destinacion kryesor të kredisë kanë rritjen e prodhimit dhe gjenerimin e mjeteve për kthim të kredisë. Pas procesit të privatizimit pritet që numri i fermerëve komercialë të jetë shumë më i madh. Prodhimtaria bimore e drithërave, bimëve industriale dhe perimeve paraqet një rrezik për kreditim nga bankat. Kreditimi do të avancohej shumë me zhvillimin e sistemit të sigurimit të këtyre kulturave nga kompanitë e shumta siguruese që veprojnë në Kosovë, metodë kjo që ka treguar sukses në vendet e zhvilluara.

6.5 Asistenca teknike në bujqësi

Zonat rurale kanë qenë zonat më të dëmtuara nga lufta në Kosovë. Dëmet kanë qenë në objekte banimi, objekte të tjera përcjellëse, mekanizim, blegtori etj. Në një situatë të këtillë fermerët menjëherë pas luftës kanë qenë më tepër të fokusuar në rindërtimin e objekteve të banimit. Kjo ka ndikuar shumë që të dobësohet aftësia investive e familjeve rurale në rimëkëmbjen e prodhimit bujqësor. Edhe pse ka pasur mjaft ofrues të ndihmës nga organizata të ndryshme, qoftë qeveritare apo joqeveritare, të cilat kanë ndihmuar në forma të ndryshme riparimin e dëmeve nga lufta, rreth 38 % e familjeve rurale dhe 34 % e familjeve urbane, të cilat kanë pësuar dëme, kanë deklaruar se nuk kanë marrë kurrfarë ndihmash. Ndihmat me material ndërtimor dominojnë në strukturën e asistencës së ofruar (88 %).

Ndihmat për sektorin e bujqësisë kanë qenë të ndryshme. Farëra të ndryshme kanë marrë 17.15 % e familjeve të anketuara, plehëra kimike 12.73 % e familjeve dhe lopë qumështore 3.71 % e familjeve të përfshira në anketë.

Tab.20 Të dhënat për familjet urbane dhe rurale që kanë marrë ndihma për të riparuar shtëpitë nga dëmet e e luftës (%)

	Urbane	Rurale
Nuk kanë pasur nevojë	55.2	34.7
Kanë pasur nevojë, por nuk kanë marrë ndihma	33.8	37.5
Kanë pasur nevojë dhe kanë marrë ndihma	10.9	27.8
Totali	100.0	100.0

Burimi: Anketa me familje, Riinvest, 2004

Tabela 21. Llojet e ndihmës për kategorinë e familjeve që kanë pranuar ndihmë për riparim të shtëpisë (%)

Llojet e ndihmës	Urbane	Rurale
Ndihmë teknike, këshilla dhe informacione	5.9	0.6
Material ndërtimor	74.5	88.1
Para të gatshme (vauçer)	0.0	1.9
Tjetër	13.7	9.4
Pa përgjigje	5.9	0.0
Totali	100.0	100.0

Burimi: Anketa me familje, Riinvest, 2004

Përveç këtyre ndihmave, familjet rurale janë ndihmuar edhe me këshilla profesionale (asistencë teknike) e në raste më të rralla edhe me para të gatshme (vauçer). Ndërsa te

familjet urbane, pas materialit ndërtimor, dominojnë ndihmat në ushqim (26 % e familjeve urbane kanë marrë ndihma ushqimore).

Më herët në Kosovë ka ekzistuar një lidhmëri ndërmjet shërbimeve këshillimore (i organizuar kryesisht nga kooperativat bujqësore dhe komunat). Si pasojë e situatës nëpër të cilën ka kaluar Kosova, këto lidhje janë shkëputur. Ky ka qenë edhe një faktor që ka ndikuar në ngecjen e rritjes së prodhimit bujqësor (në këtë kanë ndikuar edhe një kompleks faktorësh të tjerë të cilët do të përmenden më vonë). Në periudhën e pasluftës, në fillim ka pasur përpjekje që kjo ndihmë të ofrohet përmes organizatave të ndryshme joqeveritare (të jashtme dhe vendëse), nga komunat, Ministria etj. Të dhënat e marra nga anketat me familjet rurale tregojnë se efektet e këtyre këshillave kanë qenë mjaft të vogla (Tabela në vijim).

Tab. 22. Burimi i këshillave për zgjedhjen dhe përdorimin e inputeve dhe bagëtisë (në %)

Lloji	Këshilltari profesional (Ministria-Komuna)	Shoqata e prodhuesve	Të afërmit-familja	Tregtari-shitësi	Kooperativa	Të tjera	Pa përgjegje
Plehërat kimike	3.7	2.1	53.3	9.5	0.5	30.8	0.0
Farërat	0.8	3.2	41.1	7.1	1.4	23.3	23.1
Pajisjet (Mekanizimi)	1.1	1.1	33.5	3.8	0.8	28.5	31.0
Zgjedhja e bagëtisë	1.9	1.3	41.7	4.1	0.2	25.8	24.9

Burimi: Anketa me familje, Riinvest, 2004

Tab. 23. Niveli i përdorimit të farës cilësore nga fermerët (%)

Kulturat bujqësore	E blerë	E ruajtur nga viti paraprak
Grurë	78.9	21.1
Misër	75.4	24.6
Domate	80.1	19.9
Lakra	85.8	14.2
Elb	66.4	33.6
Patate	79.8	20.2
Qepë	89.2	10.8
Specat	75.6	24.4

Burimi: Anketa me familje, Riinvest, 2004

Të dhënat tregojnë se duhet gjetur forma më efektive të komunikimit me fermerë, pasi që pjesa më e madhe e tyre ende përdorin burime shumë të pasigurta të informimit për zgjedhjen e farës, plehërave, pajisjeve dhe bagëtisë. Si rezultat i kësaj është ende shumë e theksuar mënyra tradicionale e prodhimit bujqësor.

MBPZHR, së bashku me Agjencionin Evropian për Rindertim, ka filluar implementimin e projektit për shërbimet këshillimore. Parashihet që të ndërtohet një sistem i kombinuar i shërbimeve këshillimore, publik dhe privat. Sektori publik (këshilltarët në drejtoritë komunale për bujqësi dhe nga Ministria e Bujqësisë) do të ndihmojë fermerët e vegjël që të orientohen nga prodhimi komercial. Ndërsa, krahas këtij shërbimi, do të ngriten edhe shërbime këshillimore private, të cilat do të punonin kryesisht me fermerët komercialë, shërbimet e të cilave do të paguhen nga fermerët.¹⁰

Kuadri institucional publik i cili potencialisht mund të ofrojë shërbime këshillimore gjendet në 30 komuna në stafin bujqësor të MBPZHR. Krahas stafit bujqësor nëpër komuna është edhe stafi në zyrat fushore (rajonale) të Ministrisë, që punon në çështjet e zhvillimit rural. Pothuajse të gjitha komunat kanë një drejtor për bujqësi dhe numri mesatar i zyrtarëve të bujqësisë për çdo drejtor komunale është 3-5 zyrtarë.

Tab. 24. Ndikimi i këshillave në ndryshimin e mënyrës tradicionale të përdorimit të farërave dhe plehërave

Ndikimi i ndihmës	Farërat	Plehërat
Ka ndikuar	27.0	25.7
Do të përdorë ato të parandihmës	54.5	25.7
Do të kaloj në përdorimin e farërave tradicionale- plehërave të tjera	17.0	7.1
Nuk do të mbjell në të ardhmen	1.1	1.4
Pa përgjigje	-	4.3

Burimi: Anketa me familje, Riinvest, 2004

6.6 Mekanizimi në bujqësi dhe masat agroteknike

Aplikimi i mjaftueshëm dhe në mënyrë të drejtë i mekanizimit në prodhimin bujqësor është njëri ndër parakushtet për prodhimtari të suksesshme bujqësore. Nga analiza për familjet rurale vërehet se traktorë posedojnë 48.9 % e familjeve rurale. Këta traktorë zakonisht nuk përdoren vetëm për punë në bujqësi (por edhe për transport, për punë në ndërtimin e shtëpive etj.). Mungesë më e theksuar vërehet tek makinat bashkangjitime dhe motokultivatorët. Organizimi i fermerëve në shoqata do ta lehtësonte shumë këtë problematikë, pasi që është e njohur se nuk është racionale që çdo fermer të blejë një makinë mbjellëse, të cilën do ta përdorë një herë në vit. Në këtë drejtim janë bërë disa hapa fillestarë në disa kooperativa të mekanizimit të formuara me programin danez, në territorin e Rrafshit të Dukagjinit.

10 MBPZHR, Strategjia e ndërtimit të shërbimeve këshillimore në bujqësi dhe zhvillimin rural të Kosovës, nëntor 2003

Tab. 25. Gjendja e mekanizimit bujqësor në familjet rurale (%)

	Posedon	Huazon	Merr me qira	Nuk e përdor
Traktor	48.9	8.5	23.4	19.2
Motokultivator	33.3	6.7	18.3	41.6
Plug	40.7	1.4	26.2	20.7
Makinë mbjellëse	10.0	10.0	52.3	27.8
Kamion	9.7	4.1	11.0	75.1
Veturë	69.0	6.0	5.4	19.5

Burimi: Anketa me familje, Riinvest, 2004

6.7 Ndërmarrësia rurale

Duke marrë parasysh sipërfaqen e kufizuar të tokës për një familje, si dhe dendësinë e popullsisë, është e qartë se në kushtet e Kosovës vetëm bujqësia nuk mund të sigurojë zhvillim të suksesshëm rural. Për të mbështetur zhvillimin e zonave rurale një rëndësi të posaçme i duhet kushtuar nxitjes së kulturës ndërmarrëse dhe zhvillimit edhe të bizneseve jobujqësore, që do të thotë bizneseve familjare komplementare. Nga të dhënat e përmendura më herët në raport dhe nga krahasimet e bëra u vërejtën kushtet favorizuese për zhvillimin e bizneseve dhe ndërmarrësisë në zonat urbane krahasuar me ato rurale, si nga aspekti i infrastrukturës ashtu edhe i sistemit të mbështetjeve të tjera për mundësitë e gjenerimit të bizneseve. Megjithatë, në viset rurale janë duke u zhvilluar disa biznese që mund të kenë perspektivë edhe më tutje: përpunimi i drurit, që kohëve të fundit po zhvillohet mjaft shumë, pastaj përpunimi i produkteve bujqësore, bizneset për grumbullimin e kërpudhave dhe frutave të tjera pyjore, bletaria, bimët mjekuese. Një mundësi tjetër ka të bëjë me turizmin fashatar, i cili është fare pak prezent.

Zhvillimi i sektorit jobujqësor në zonat rurale mund të ndikojë dukshëm në ngritjen e nivelit të të ardhurave dhe në uljen e papunësisë, pasi që efekti i sektorit të bujqësisë është i vogël në këtë aspekt. Për të nxitur zhvillimin e bizneseve rurale, qeveria qendrore, komunale dhe agjencionet kosovare e ndërkombëtare që mbështesin bizneset e vogla dhe të mesme do të duhej të fokusohen gjithashtu në krijimin e kushteve për zhvillimin e bizneseve familjare, që do të krijonte një ambient të favorshëm për biznesin rural. Faktorë relevantë në mbështetjen e këtyre bizneseve është ndërtimi i kapaciteteve institucionale në pushtetin vendës, komunitetet, organizatat e shoqërisë civile, shërbimet financiare rurale që u përmendën më herët. Ndoshta zgjidhja duhet kërkuar tek përfitimi nga tradita e ekzistimit të ekonomive familjare në Kosovë dhe injektimi te këto ekonomi i elementeve bashkëkohore të menaxhimit të bizneseve të vogla dhe orientimi i tyre kah tregu. Për këtë do të duhej të zhvillohet një program i veçantë i akterëve të interesuar për zhvillimin e ndërmarrësisë në Kosovë. Mund të konsiderohet se këtu janë hapësirat më të mëdha për ndryshime, si të gjenerimit të punësimit ashtu edhe të të ardhurave në viset rurale.

Fushë tjetër në nxitjen e ndërmarrësisë rurale do të ishte mbështetja e fermerëve në zgjerimin e bizneseve të tyre me aktivitete komplementare dhe suplementare që janë të ndërlidhura me punën e tyre në fermë që njëherit do ta bënte më efikase atë. Kjo mbështetje do të mund të bëhej në formë programi në mes të dy pushteteve – qendrore dhe lokale, duke përfshirë akterë relevantë të zhvillimit rural.

Programi do të mund të ofronte një varg trajnimesh dhe mbështetjesh në fusha të ndryshme, siç do të ishte organizimi dhe kooperimi i disa fermerëve për kryerjen e aktiviteteve të përbashkëta, përgatitja e planeve të bizneseve, zhvillimi i produkteve dhe marketingut, mbajtja e evidencës kontabël, krijimi i shoqatave kursimoro-kreditore dhe përfshirja në skemat e mikrokreditimit (shiko shembullin e ndërmarrësisë rurale në Slloveni – Boxi 1)

Boxi 1: Ndërmarrësia rurale - BSP Kranj (Slloveni)

BSC Kranj është agjenci për mbështetjen e biznesit në rajonin e Kranjit, e themeluar në vitin 1994 me ndihmën e Programit Evropian PHARE. Kjo agjenci zhvillon aktivitete të shumta këshillimesh, trajnimi, asistencë në mikrofinancim dhe financim, marketing dhe udhëheqje të biznesit.

Projekti mbi ndërmarrësinë rurale ka për qëllim mbështetjen e aktiviteteve komplementare dhe suplementare të fermerëve, sidomos të atyre që nuk mund të sigurojnë të ardhura të mjaftueshme dhe punësim të plotë vetëm me bujqësi. Programi zbatohet gjatë katër vjetëve të fundit dhe financohet 50 % nga qeveria e Sllovenisë dhe 50 % nga komunat. Partnerë në realizimin e projektit është edhe Shërbimi Nacional i Odës së Bujqësisë, e cila anëtarëson fermerët e Sllovenisë. Ajo i ndihmon fermerët në teknikat e planifikimit, me makina bujqësore dhe me masa të tjera agroteknike.

Projekti i ndërmarrësisë rurale zhvillohet katër vitet e fundit dhe ka të bëjë me:

- (a) evidentimin e produkteve komplementare dhe suplementare të fermerëve dhe botimin e katalogut përkatës;*
- (b) trajnimin e tyre për të përmirësuar produktin (disenji, cilësia);*
- (c) Puna në grupe të vogla në formë të mikrokclusterës (rrjet i vogël). Deri tani kanë formuar grupin e prodhuesve mbi punimet zejtare dhe artizanatet, grupi i prodhuesve të llojeve të ndryshme të bukës, prodhuesve të çajrave, pylltarisë dhe prodhimeve të drurit si dhe të turizmit fshatar. Puna në këto grupe ndihmon që të zhvillohet bashkëpunimi dhe të mësohet nga përvojat reciproke;*
- (d) Ndihma në mbajtjen e evidencës kontabël;*
- (e) Mbështetja për t'u inkuadruar në skemat e mikrokreditimit;*
- (f) Marketingu;*

Projekti bën udhëheqjen e procesit prej fillimit deri në fund, kështu që eviton problemet që paraqiten gjatë këtij procesi. Të gjithë pjesëmarrësit asistohen për sigurimin e tregut, me ç'rast përdoret një emër tregtar (Trade Mark, Brand name, konkretisht për punimet zejtare është "Për shtëpinë time") dhe për këtë duhet të përmbushin kushtet dhe kërkesat që kanë të bëjnë me cilësinë dhe disenjin. Në katalogun e këtij projekti janë përfshirë rreth 300 fermerë nga ky rajon. Katalogu përmban përshkrimin e produktit dhe mënyrën e kontaktimit dhe porosisë nga prodhuesi. Aty gjithashtu qartazi dallohet prodhimi i integruar ekologjik. BSC Kranj tani realizon shitjen e produkteve të këtyre fermerëve në shitoret kryesore të Sllovenisë. Kërkesa është më e madhe sesa mundësia për ofertë. BSC realizon një provizion të vogël nga shitja.

6.8 Organizimi i fermerëve nëpër shoqata

Pjesëmarrja (anëtarësia) në shoqata e fermerëve kosovarë është shumë simbolike. Vetëm 1.5 % e fermerëve (të anketuar) janë anëtarë të shoqatave të prodhuesve, kurse 0.8 % janë anëtarë të kooperativave. Edhe të dhënat tjera indikojnë dobësi në nivelin e organizimit dhe të veprimit institucional. Shkaqet për një nivel kaq të ulët të organizimit të tyre janë të shumta. Në rend të parë është mosnjohja e rëndësisë së anëtarësimit në shoqata, benificionet që mund t'i kenë ata nga ky anëtarësim; si qasja më e lehtë në treg, shfrytëzimi më racional i mekanizmit bujqësor, këmbimi i informatave me interes me fermerët tjerë etj. Në një situatë të këtillë ata nuk kanë qenë në gjendje që të bëjnë një presion më të madh tek organet qeveritare dhe ato të UNMIK-ut për krijimin e një politike më të favorshme fiskale dhe të përkrahjeve të tjera për nevojat e bujqësisë, në përgjithësi për mbrojtjen e interesave të tyre. Janë disa raste pozitive të cilat mund të merren si shembull i mirë, siç është p.sh. shoqata e kultivuesve të perimeve “Anadrini” në Xërxë të Rahovecit, e cila ka arritur të krijojë një infrastrukturë të mirë organizative. (Shiko Box-in 2)

Organizimi më i mirë i fermerëve është një parakusht i rëndësishëm për forcimin e tyre. Në rend të parë duhet punuar në ngritjen e kapaciteteve të shoqatave (sidomos bordeve të tyre), për organizim dhe menaxhim më të mirë të punës me shoqatë dhe për ndërmarrjen e programeve të veçanta për ngritjen e kapaciteteve të tyre.

Boxi 2: SHFKP “Anadrini”

Shoqata e fermerëve-kultivuesve të perimeve “Anadrini” është themeluar në dhjetor të vitit 1999, në fshatin Xërxë të komunës së Rahovecit. Shoqata ka një anëtarësi mesatare vjetore prej 500 fermerësh, të cilët prodhojnë perime në sipërfaqe të mëdha, pjesa më e madhe e të cilave është e dedikuar për treg.

Shoqata është e regjistruar, ka Kuvendin e Shoqatës, Bordin Drejtues prej 6 anëtarësh dhe ekzekutivin.

SHFKP “Anadrini” veprimtarinë e saj e ka përqendruar në këto 4 shtylla veprimi:

- *Avokimi – mbrojtja e të drejtave të fermerëve;*
- *Trajnimet profesionale të përcjellura edhe me shërbimet e ekstensionit;*
- *Ndihmesa në sigurimin e inputeve cilësore bujqësore, kryesisht hibrideve të perimeve; dhe*
- *Ndihmesa në marketingun e perimeve bashkë me sigurimin e kredive për fermerët e mëdhenj, anëtarë të shoqatës.*

Deri më tani, shoqata ka organizuar dhe ka mbajtur rreth 200 trajnime, nga ekspertë të jashtëm dhe vendës, ku janë trajnuar më shumë se 3000 fermerë dhe aktivistë të shoqatës në disa fusha të agrobiznesit dhe të lidhura me të, siç janë: përdorimi i pesticideve, marketingu, menaxhimi i shoqatave, avokimi, prodhimtaria ekologjike e perimeve, prodhimtaria e perimeve në serra etj.

Në marketingun e perimeve të anëtarëve të saj, shoqata ka bërë një punë modeste, pasi që ka shfrytëzuar ndihmë nga kompanitë vendëse dhe të huaja që sasi të konsiderueshme të perimeve të eksportohen jashtë vendit, si në Zvicër, IRJM, Serbi dhe Shqipëri. Sa i përket tregut vendës, shoqata ka raporte të mira me fabrikën për përpunimin e fruta-perimeve IU ABI&ELIF 19 “Progresi” nga Prizreni, me të cilën çdo vit lidhen kontrata bashkëpunimi për shitblerjen e perimeve për aq sa janë kapacitetet e kësaj ndërmarrjeje përpunuese.

Synim vendimtar dhe kryesor i shoqatës është prodhimtaria e perimeve në ambiente të mbrojtura (serra), si dhe ndryshimi i teknologjisë prodhuese bashkë me përdorimin e farës hibride, për shkak se vetëm në këtë mënyrë mund të rritet rendimenti për njësi të sipërfaqes, si dhe të përmirësohet pozita materiale e fermerit vendës.

Mesatarja e tokës që posedojnë anëtarët është 2.5 – 3.0 ha, por anëtarët marrin edhe tokë tjetër me qira. Sipërfaqja e tokës së punueshme, e anëtarëve, zakonisht është e mbjellur 50 % me perime dhe 50 % me kultura foragjere dhe drithëra. Pjesa më e madhe e prodhimeve shitet në lokacionin e anëtarëve, ku vijnë e furnizohen tregtarët me shumicë.


6.9 Tregu i tokës dhe privatizimi

Rreth 87 % e tokës bujqësore në Kosovë është në pronësi private, ndërsa 13 % është pronë shoqërore dhe AKM ka mandatin për ta administruar atë.

Pasi që prona bujqësore është shumë e vogël, kjo nuk siguron prodhimtari rentabile dhe konkurruese, hapja e tregut të tokës është parakusht për transformimin e bujqësisë. Sipas të dhënave nga anketa me familjet rurale, 67 % e fermave janë deri në 2 ha, që është edhe madhësia mesatare e tokës bujqësore për familje në Kosovë.

Shitblerja e tokës ka qenë mjaft prezente gjatë viteve 1980 deri 1996, kur edhe është ndërprerë për arsye të situatës së vështirë ekonomike dhe politike. Kjo tregohet edhe nga të dhënat e anketës, e cila na tregon se 33 % të respondentëve që kanë blerë tokë këtë e kanë bërë gjatë periudhës 1980-89, ndërsa rreth 28 % gjatë viteve 1990-99 (shiko grafikun). Të dhënat e sakta për çmimin e shitblerjes të tokës është vështirë të përcaktohen, sepse në dokumentacion janë vendosur vlera më të vogla për pagesë më të vogël të taksave dhe të shërbimeve. Vlerësohet se çmimi i tokës në atë kohë ka qenë në mes 100.000 - 500.000 DM¹¹ për një hektar, varësisht nga lokacioni dhe përdorimi i tokës. Ky çmim ka qenë shumë i lartë krahasuar me çmimin e tokës në vendet tjera dhe jo i arsyeshëm kur të llogariten rendimentet e arritura dhe profitabiliteti nga toka bujqësore.

Fig.6 Blerjet e tokës në periudha të caktuara (%)



Burimi: Anketa me familje, Riinvest, 2004

Në vitet e pasluftës, është karakteristike shitblerja shumë më e vogël e tokës bujqësore, si dhe çmimet më të ulëta, që dallojnë varësisht nga rajoni ku ndodhet toka. Ende paguhen çmime të larta në pjesët me tokë bujqësore të limituar, për tokën afër rrugëve kryesore, tokën me mundësi të ujitjes dhe në rajonet ku mund të prodhohen perimet, siç është rajoni i Anadrinit. Shitblerja e vogël e tokës është si rrjedhojë e mungesës së parave të gatshme si dhe e migrimit të popullsisë rurale në pjesët urbane ku është zvogëluar interesimi për blerje. Kuptohet se çmimi i tokës është më i lartë në hapësirat ku mund të ndërtohen shtëpi, stacione karburanti, restorante, depo, pishina etj.

¹¹ IFDC, Studimi i përdorimit të tokës, 2001

Regjistrimi i pronës (sidomos asaj në pjesët rurale), si pasojë e situatës së përgjithshme në të cilën ka kaluar Kosova, ka qenë i përcjellur me shumë vështirësi. Gjate viteve '90, për qëllime politike Serbia ka vendosur në Kosovë ligjin për ndalimin e transaksioneve të paluajtshmërisë ndërmjet nacionaliteteve të ndryshme. Shumica e pronave të cilat janë blerë nga blerësit shqiptarë gjatë kësaj kohe nuk kanë mundur të regjistrohen. Në përgjithësi (në bazë të rezultateve të anketës) 18.1 % e familjeve rurale dhe 12.1 % e familjeve urbane kanë pronë të paregjistruar. Problem tjetër në këtë çështje është edhe fakti se për pronën e paregjistruar ka mungesë të theksuar të dokumentacionit. Për pronat e paregjistruara në zonat rurale, dokumentacionin e nevojshëm e posedojnë 34.7 %, ndërsa në zonat rurale 22.2 % e poseduesve të tanishëm.

Tab. 26. Familjet rurale dhe urbane që kanë pronë të paregjistruar (%)

	Rurale	Urbane
Nuk kanë pronë të paregjistruar	80.4	87.8
Kanë pronë të paregjistruar	18.1	12.2
Pa përgjigje	1.5	-----
	100.0	100.0

Anketa me familje, Riinvest, 2004

Të dhënat nga tabela tregojnë për një nivel të lartë të familjeve që kanë prona të paregjistruara. Ky problem mund të ketë pasojë edhe në shfrytëzimin e tokave dhe në pamundësinë e fermerëve që këtë tokë ta përdorin si hipotekë gjatë aplikimit për kredi te bankat e ndryshme.

Është me rëndësi që organet ligjvënëse të gjejnë forma të ligjshme për të bërë regjistrimin e këtyre pronave.

Vitet e fundit është mjaft e përhapur marrja me qira e tokave bujqësore nga privatët dhe më tepër nga kombinatet bujqësore shoqërore. Çmimi i qirasë varet nga cilësia e tokës, mundësia e ujitjes dhe lloji i kulturave që mbillen. Në vendet pa mundësi të ujitjes, ku zakonisht mbillet gruri, elbi, misri dhe ndonjëherë luledielli dhe soja çmimi sillet rreth € 50 për një hektar dhe toka kryesisht merret me qira nga kombinatet bujqësore. Nëse ekziston mundësia për ujitje, çmimi i qirasë sillet rreth € 150-200 për hektar. Çmime shumë më të larta paguhen për marrje me qira të tokës në rajonin e Anadrinit (komunat Prizren, Rahovec dhe Gjakovë), që sillen rreth € 300 - 400 nga kombinatet shoqërore dhe € 1.000-1.500 nga privatët.

Sipas informatave nga komunat Gjakovë, Prizren dhe Rahovec procesi i shitblerjes është mjaft i thjeshtë. Në disa komuna paguhet taksa për shërbime që është simbolike, ndërsa ka raste si në komunën e Gjakovës ku nuk paguhet taksa për shërbime. Problem kryesor paraqitet regjistrimi i tokës në personat që dëshirojnë të shesin atë, ku nevojiten të jenë prezent të gjithë poseduesit për nënshkrim (shembull: duhet të jenë prezent prindërit dhe të gjithë vëllezërit dhe motrat e personit që e shet tokën, e shpesh ndodh që ata duhet të vijnë nga vendet jashtë Kosovës për të nënshkruar dokumentin për shitblerje).

Në fund të themi se çmimi i tokës është ende i lartë krahasuar me vendet në rajon dhe duke pasur parasysh fitimin në sektorin e bujqësisë, që është i ulët. Privatizimi i tokës në pronësi shoqërore, me siguri se do të ndikojë në uljen e çmimit të tokës në pronësi

private, në konsolidimin e tregut të tokës, në shtimin e fermave bujqësore dhe në rritjen e profitabilitetit.

Edhe pse shumica e tokës është në pronësi private, privatizimi më i shpejtë i tokës në pronësi shoqërore do të ndikonte mjaft mirë në avancimin e përgjithshëm të prodhimit bujqësor. Duke pasur parasysh faktin se këto toka ndodhen në komplekse të mëdha (nuk janë shumë të parcializuara, siç është rasti me tokat në sektorin privat), kjo do të ndikonte në rritjen e madhësisë së fermave e me këtë edhe në krijimin e mundësive më të mira për prodhim më të avancuar bujqësor. Çështja e privatizimit të tokës bujqësore në pronësi shoqërore duhet të zë vend të posaçëm në kuadër të procesit të privatizimit. Derisa të hyjë në procedurë privatizmi i tokës bujqësore, sa më parë duhet të formohet një Fond publik për mbrojtjen dhe menaxhimin e tokës nëpërmjet dhënies me qira të saj.

6.10 Organizimi institucional dhe legjislacioni në bujqësi

Pas përfundimit të luftës, në vitin 1999 në Kosovë filloi organizimi institucional edhe në fushën e bujqësisë. Në kuadër të UNMIK-ut, njëri nga këto departamente ishte edhe Departamenti i Bujqësisë. Me kalimin e kohës, ky u avancua në Departamentin Tranzicional të Bujqësisë. Pas mbajtjes së zgjedhjeve të para të nivelit qendror u krijuan ministritë, dhe në shtator të vitit 2002 u formua edhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me mandat për krijimin e politikave, strategjive, legjislacionit dhe monitorimit të implementimit të tij. Një numër i funksioneve (Shërbimi veterinar, shërbimi kufitar, fitosanitar dhe veterinar, pastaj zyra për pyje publike) mbeten të drejta të rezervuara për UNMIK-un në kuadër të Drejtoratit për Çështje Rurale. Në janar të vitit 2004, në kuadër të transferit të kompetencave, Shërbimi Veterinar i Kosovës u transferua në Ministrinë e Bujqësisë.

Bujqësia në buxhetin e Kosovës përfaqësohet me vetëm 0.63 % (2.4 milionë euro).¹² Kjo shumë (rreth 1 euro/banor) është tepër e vogël për të ndihmuar në zhvillimin e bujqësisë. Në nivelin lokal nëpër shumicën e komunave të Kosovës po ashtu u konstituuan organet lokale për bujqësi të quajtura drejtorate komunale dhe sot në 22 komuna të Kosovës ekzistojnë organe të tilla. Në 8 komunat tjera bujqësia udhëhiqet nga forma me të ulëta të organizimit si p.sh. seksionet për bujqësi, të cilat janë në kuadër të drejtorateve për ekonomi. Numri i përgjithshëm i punëtorëve në komuna, duke përfshirë edhe inspektorët bujqësorë dhe veterinarë, është rreth 150.

Është e qartë se duhet të punohet shumë në krijimin dhe në mbështetjen e mëtutjeshme të reformave të politikave, në mënyrë që të krijohet një ambient politik sa më favorizues për zhvillimin e viseve rurale. Zhvillimi i tregut të mirëfilltë të tokës dhe në përgjithësi i politikës së administrimit të tokës duhet të ketë prioritet të lartë. Qeveria ka krijuar një Komitet Bashkërendues Ndërminstrior për politikën e administrimit të tokës, në të cilin komitet Ministria e Bujqësisë merr pjesë dhe prezenton idetë e lartpërmendura. Njëra nga politikat e MBPZHR në këtë drejtim ka të bëjë edhe me formimin e Fondit të Tokave të Kosovës, trup ky i cili do të përfshinte tokat në pronësi shoqërore dhe dhënien me qira

¹² Projekti i Statistikave Bujqësore dhe Njësia Këshilluese Politike (ASPAUK), MBPZHR dhe ESK. Raport i misionit të parë, mars 2004.

deri në privatizimin e tyre. Kjo do të rriste prodhimtarinë bujqësore përmes punimit të tokave të cilat tash janë kryesisht djerrina, sepse ndërmarjet shoqërore nuk kanë resurse të mjaftueshme për punimin e tyre, por edhe do të inkurajonte tregun e tokës, si dhe marrëdhëniet e reja ndërmjet qiradhënësve dhe qiramarrësve.

MBPZHR ka përgatitur edhe librin e gjelbër apo “Strategjia për zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor dhe rural në Kosovë” në periudhën afatmesme, që është zyrtarizuar nga Ministria e Bujqësisë në maj të vitit 2003, në të cilën prezentohen politikat dhe opsionet strategjike për zhvillimin e bujqësisë dhe të sektorit rural. Në këtë dokument konkludohet se çështja kryesore në zhvillimin rural është zbutja e papunësisë rurale dhe ekziston nevoja për gjetjen e mundësive të reja për punësim dhe aktivitete të reja të shumëllojshme në sektorët jashtë fermës.

Për të realizuar intencat kryesore të politikave agrare të parapara në këtë dokument, mes të tjerash, masat e politikës bujqësore duhet të orientohen drejt përmirësimit të kapaciteteve infrastrukturale dhe standardit shoqëror në viset rurale; në mbështetjen financiare të fermerëve përmes bankave dhe institucioneve të tjera financiare me linja të përshtatshme kreditimi; në zhvillimin e shërbimeve këshillimore, institucioneve mikrofinanciare dhe të kursimit, si dhe shërbimeve të tjera për fermerë dhe të përgatiten propozimet e projekteve për investime.

Pas themelimit të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë (IPVK), nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është hartuar programi legjislativ, gjegjësisht programi i hartimit të ligjeve të reja nga lëmia e bujqësisë. Ky program është miratuar nga Qeveria e Kosovës. Me këtë program parashihet hartimi dhe aprovimi i një numri ligjesh nga lëmi i bujqësisë.

Deri më tani janë miratuar gjithsej 6 ligje (Ligji për pyjet, për farërat, për kooperativat bujqësore, për plehërat artificiale, për pesticidet dhe ai për materialin fidanor). Është aprovuar në parim edhe Ligji për Veterinarinë. Gjithashtu, është përgatitur për aprovim edhe Ligji për blegtorinë.

Përshpejtimi i aprovimit të ligjeve nga sektori i bujqësisë dhe zhvillimit rural në përgjithësi, është parakusht shumë i rëndësishëm për zhvillimin e këtij sektori. Duke pasur parasysh faktin se për çdo vit po zvogëlohet fondi i tokës bujqësore, aprovimi i Ligjit për mbrojtjen e tokës bujqësore është nevojë urgjente. Gjithashtu, është mjaft e nevojshme që të aprovohen sa më parë edhe Ligji mbi pronën, Ligji mbi kontrollin e cilësisë së ushqimit dhe ligjet tjera.

REFERENCAT

Renewed Strategy for Rural Development – Reaching Rural Poor, World Bank
Strategjia e ndërtimit të shërbimeve këshillimore në bujqësi dhe në zhvillimin rural të Kosovë, MBPZHR, nëntor 2003;

Kosovo: Re-launching the Rural Economy, World Bank, November 1999;

Strategjia për zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor dhe rural në Kosovë, MBPZHR, maj 2003, Prishtinë;

Strategjia e zhvillimit rural për Shqipërinë – Mbështetje për rritje ekonomike dhe zhvillim të qëndrueshëm, nëntor 2002;

Masat për përmirësimin e politikave fiskale dhe tregtare në bujqësi dhe pylltari, MBPZHR, janar 2004;

Kosovo Economic Memorandum, World Bank, May 2004, Prishtinë;

The sirens' song of agriculture: Opportunities and traps for Kosova, Report prepared for Riinvest by Richard Beilock, Janar 2004;

The 2004 Kosova household survey report, Prepared for Riinvest by Richard Beilock;

Agricultural Policies in Transition Economies – Trends in Policies and Support, Raport i OECD-së 2002.

Studimi Makroekonomik për sektorin e Bujqësisë: Taksimi, çmimet, mekanizmat tregtare dhe nxitëse në bujqësi dhe në sektorin e ushqimit në Kosovë, GFASTOAS 2002;

Projekti i Statistikave Bujqësore dhe Njësia Këshilluese Politike (ASPAUK), MBPZHR dhe ESK. Raport i misionit të parë, mars 2004. IFDC, studimi i përdorimit të tokës, 2001

Sistemi i arsimit dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës, Riinvest, 2004;

Statistikat e punës dhe punësimit të vitit 2002 në Kosovë, MPMS, maj 2003:

Kosovo Poverty Assesment, World Bank, dhjetor 2001;

Tregu i punës dhe papunësia, Riinvest, 2003;

Statistikat e bujqësisë në Kosovë; ESK, FAO, MBPZHR, 2001;

Rindërtimi i Kosovës pas luftës – Strategjia dhe politikat, Riinvest, 2001;

Ripërtëritja dhe rindërtimi i Kosovës pas luftës, Riinvest, 1999;

Anketa e Riinvestit me familje dhe me tregun e punës (2002);

Studimet e Entit për Zhvillim dhe Planifikim të Kosovës (1988);

Anketa e vitit 1999/2000 përgatitur nga UNFPA, ESK, IOM, 2000;

Establishment of a level playing field for Kosova food and agricultural products, Alliance of Kosova Agri-business March 2001;

Vjetari statistikor i Kosovës dhe RFJ, vitet e ndryshme, Riinvest (1998);

Status of technical work on agricultural policy and recommendations for a policy framework for Kosova and status of technical work on the privatization /commercialization of agricultural assets in Kosova, IFDC Kosova Agribusiness Development Program, November 2000;

BPK, Monthly Statistics Bulletin, March 2004.